

P Ë R M B A J T J A

RAPORT MBI PUNËN E AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS PËR VITIN 2005	11
I. KUVENDI	13
II. KRYESIA.....	16
III. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	23
IV. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE.....	28
V. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS.....	32
VI. SEKSIONI I ARTEVE	36
VII. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE	39
PROGRAMET E PUNËS TË SEKSIONEVE TË ASHAK PËR VITIN 2006	41
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	43
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE.....	44
SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	45
SEKSIONI I ARTEVE	46
PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS	47
VENDIMI DHE RREGULLORJA PËR QENDRËN LEKSIKOGRAFIKE-ENCIKLOPEDIKE	61
KRONIKË - 2005	69

KRYESIA

Akademik **Rexhep Ismajli**, kryetar

Akademik **Besim Bokshi**, nënkryetar

Akademik **Hivzi Islami**, sekretar i përgjithshëm

Akademik **Eqrem Basha**, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë

Akademik **Ekrem Murtezai**, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore

Akademik **Muharrem Berisha**, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës

Akademik **Rauf Dhomi**, sekretar i Seksionit të Arteve

ANËTARËT E AKADEMISË

I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Ali Aliu (1934), i zgjedhur në vitin 2000.

Ali Podrimja (1942), i zgjedhur në vitin 2000.

Besim Bokshi (1930), i zgjedhur më 1996.

Enver Gjerqeku (1928), i zgjedhur më 1991.

Eqrem Basha (1948), i zgjedhur në vitin 2004.

Idriz Ajeti (1917), i zgjedhur më 1975.

Rexhep Ismajli (1947), i zgjedhur më 1996.

Rexhep Qosja (1936), i zgjedhur më 1975.

b) Anëtarët korrespondentë:

Mehmet Kraja (1952), i zgjedhur në vitin 2004.

Sabri Hamiti (1950), i zgjedhur në vitin 2000.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Ekrem Murtezai (1931), i zgjedhur në vitin 2000.

Esat Stavileci (1942), i zgjedhur në vitin 2000.

Hivzi Islami (1946), i zgjedhur në vitin 2000.

Jashar Rexhepagiqi (1929), i zgjedhur më 1975.

Mark Krasniqi (1920), i zgjedhur më 1985.

b) Anëtarët korrespondentë:

Pajazit Nushi (1933), i zgjedhur në vitin 2000.

III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Feriz Krasniqi (1931), i zgjedhur në vitin 2000.

Minir Dushi (1929), i zgjedhur më 1979.

Muharrem Berisha (1942), i zgjedhur në vitin 2000.

Nexhat Daci (1944), i zgjedhur më 1996.

b) Anëtarët korrespondentë:

Latif Susuri (1941), i zgjedhur në vitin 2000.

IV. SEKSIONI I ARTEVE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Rauf Dhomi (1945), i zgjedhur më 1996.

Rexhep Ferri (1937), i zgjedhur në vitin 2000.

b) Anëtarët korrespondentë:

Engjëll Berisha (1934), i zgjedhur në vitin 2000.

Tahir Emra (1938), i zgjedhur në vitin 2000.

ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Musa A. Haxhiu (mjekësi), SHBA, i zgjedhur më 1983.

Remzi Bakalli (veterinari), SHBA, i zgjedhur më 1991.

Sinan Hasani (letërsi), Serbi, i zgjedhur më 1986.

Zeqirja Ballata (muzikë), Slloveni, i zgjedhur më 2000.

b) Anëtarët korrespondentë:

Ibrahim Rugova (1944), Prishtinë, i zgjedhur më 1996.

Zef Mirdita (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1991.

ANËTARËT E JASHTËM

Aleksandar Stipčević (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1983.

Ismail Kadare (letërsi), Shqipëri, i zgjedhur më 1991.

Wilfried Fiedler (gjuhësi), Gjermani, i zgjedhur më 1991.

Eric Hamp (gjuhësi), i zgjedhur më 1991.

Shaban Demiraj (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 1996.

Gunnar Svane (gjuhësi), Danimarkë, i zgjedhur më 1996.

Kristian Gyt (histori e kulturës), i zgjedhur më 1996.

Gjelosh Gjokaj (art figurativ), Gjermani, i zgjedhur më 1996.

Leonard Newmark (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur në vitin 2000.

Robert Elsie (letërsi), Kanada, i zgjedhur në vitin 2000.

Michel Roux (gjeografi, gjeopolitikë), Francë, i zgjedhur në vitin 2000.

Muhamedin Kullashi (filozofi), Francë, i zgjedhur në vitin 2000.

Tomë Berisha (elektroteknikë), Kroaci, i zgjedhur në vitin 2000.

Ibrahim Kodra (art figurativ), Itali, i zgjedhur në vitin 2000.

Noel Malcolm (histori), Angli, i zgjedhur në vitin 2004.

Victor Friedman (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur në vitin 2004.

ANËTARË NDERI

Ferid Murati, nobelist, jeton në SHBA, i zgjedhur në vitin 2000.

SHËRBIMI ADMINISTRATIV, PROFESIONAL DHE TEKNIK

Mr. Zija Bylykbashi, sekretar i Akademisë.

Lidije Kelmendi, bibliotekare.

Bedri Pllana, bashkëpunëtor profesional për financa dhe punë të prokurimit.

Fevzije Dauti, sekretare teknike e Kryesisë.

Valon Fetahu, ekspert i IT-së, redaktor teknik.

Mirishe Shala, kompjuteriste (radhitëse).

Iir Ademi, kompjuterist (radhitës).

Alban Bytyçi, shofer-korrier, mirëmbajtës i objektit.

Valbona Olluri, punëtore e bufesë – mirëmbajtëse e higjienës.

Shaip Olluri, roje e objektit.

Avdi Gashi, roje e objektit.

**RAPORT
MBI PUNËN E AKADEMISË SË SHKENCAVE
DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS PËR VITIN 2005**

I. KUVENDI

Gjatë vitit 2005, Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u mbledh tri herë, më 25 shkurt, më 29 qershor dhe më 8 nëntor 2005.

I. Në mbledhjen e 25 shkurtit (LVIII), Kuvendi, pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes LVII, i shqyrtoi edhe këto pika:

1. Raportin e punës së ASHAK-ut për vitin 2004;
2. Raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2004;
3. Programin e punës së ASHAK-ut për vitin 2005;
4. Vendimin për themelimin e Qendrës Leksikografike-Enciklopedike të ASHAK-ut dhe Rregulloren e punës së Qendrës Leksikografike-Enciklopedike të ASHAK-ut.

Kryetari i Akademisë, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, bëri vlerësimin e punës së Akademisë për vitin e kaluar. Fjala e tij do të jepet në procesverbalin e kësaj mbledhjeje, i cili do të botohet në “Vjetari” 2005. Pastaj u hap diskutimi, në të cilin morën pjesë: Sabri Hamiti, Engjëll Berisha, Zeqirja Ballata, Latif Susuri, Rexhep Ferri, Tahir Emra, Idriz Ajeti, Ali Podrimja. Ndër të tjera, u kërkua që në të ardhmen të bëhen përpjekje që raportet e seksioneve, që janë pjesë përbërëse e Raportit të Akademisë, të shkruhen me një metodologji të përafërt.

Kuvendi, pas diskutimeve, miratoi Raportin e punës së ASHAK-ut për vitin 2004.

Kuvendi, në vazhdim, miratoi edhe Raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2004, me konstatimin se ai shënon përmirësim të gjendjes financiare krahasuar me vitin e kaluar; Programin e Punës së ASHAK-ut për vitin 2005 me një pikë shtesë: *Organizimi i Konferencës shkencore me rastin e 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut*. Konferenca do të organizohet në bashkëpunim me Institutin e Historisë të Kosovës; me shumicë votash miratoi

**VENDIMIN PËR THEMELIMIN E QENDRËS
LEKSIKOGRAFIKE-ENCIKLOPEDIKE TË AKADEMISË SË
SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

- Themelohet Qendra Leksikografike – Enciklopedike e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (në vazhdim: Qendra).
- Qendra është njësi shkencore e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.
- Kuvendi i Akademisë nxjerr rregullore të veçantë me të cilën përcaktohen detyrat e Qendrës.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Akademisë.

Kuvendi, gjithashtu me shumicë votash, vendosi që miratimi i Rregullores së punës së Qendrës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit. Njëherësh, u ngrit Grupi për rishqyrtimin e Projektregullores me këtë përbërje: Besim Bokshi, Hivzi Islami, Esat Stavileci, Pajazit Nushi dhe Zija Bylykbashi.

II. Në mbledhjen e 29 qershorit (LIX), Kuvendi i Akademisë shqyrtoi dhe miratoi procesverbalin e mbledhjes LVIII të Kuvendit të Akademisë; propozimin e Programit të punës së Akademisë për vitin 2006; Statutin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës; dhe Rregulloren e punës së Qendrës Leksikografike-Enciklopedike të ASHAK-ut.

III. Në mbledhjen e 8 nëntorit (LX), Kuvendi, pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar, u mor me zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë dhe emëroi Komisionin e zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë me këtë përbërje: Esat Stavileci, kryetar, Ali Aliu, Rexhep Ferri, Feriz Krasniqi, Zija Bylykbashi, anëtarë.

Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i zgjedhjeve u tërhoq, i numëroi votat dhe konstatoi se në bazë të votave të fituara rezultoi se:

1. Rexhep Ismajli është zgjedhur kryetar i ASHAK-ut për mandatin e ardhshëm trevjeçar;
2. Besim Bokshi është zgjedhur nënkryetar i ASHAK-ut për mandatin e ardhshëm trevjeçar;

3. Hivzi Islami është zgjedhur sekretar i përgjithshëm i ASHAK-ut për mandatin e ardhshëm trevjeçar.

II. Për verifikimin e zgjedhjes së sekretarëve të seksioneve të Akademisë në bazë të numrit të votave të fituara rezultoi se:

1. Është konfirmuar zgjedhja e **Eqrem Bashës** sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë;

2. Është konfirmuar zgjedhja e **Ekrem Murtezait** sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore;

3. Është konfirmuar zgjedhja e **Muharrem Berishës** sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës;

4. Është konfirmuar zgjedhja e **Rauf Dhomit** sekretar i Seksionit të Arteve.

II. KRYESIA

Gjatë vitit 2005, Kryesia e Akademisë ka mbajtur 11 mbledhje.

1. Mbledhja XXVII e Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, e para në këtë vit, u mbajt më 6 janar 2005. Në këtë mbledhje Kryesia miratoi procesverbalin e mbledhjes XXVI të Kryesisë së Akademisë; diskutoi rreth përgatitjes së raporteve të punës për vitin 2004, ndërsa sekretarët e seksioneve morën përsipër t'i përgatisin raportet e punës për vitin 2004 dhe t'i shqyrtojnë dhe miratojnë në seksionet e tyre. Seksionet që s'i kanë miratuar programet e punës për vitin 2005 duhet ta bëjnë këtë deri në mbarim të javës së ardhshme; miratoi vendimin mbi caktimin e shumës së shpërblimeve mujore për kryerësit e funksioneve në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, duke u bazuar në Ligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës; vendosi që në Workshopin për botimet shkencore, të cilin e organizon Komiteti për të Drejtat e Autorësisë i ALLEA-së në Budapest, më 17-18 mars 2005, të marrë pjesë Hivzi Islami, përgjegjës për veprimtarinë botuese të ASHAK-ut, ndërsa në takim bienal, që e organizon Rrjeti Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut i akademive nacionale dhe asociacioneve të dijes, në Londër më 18-20 maj 2005 u vendos të marrë pjesë Rexhep Ismajli, kryetar i Akademisë.

2. Për herë të dytë brenda këtij viti Kryesia e Akademisë (XXVIII) u mblodh më 27 janar. Pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar, Kryesia shqyrtoi Raportin e punës së ASHAK-ut për vitin 2004 (të Kuvendit, të Kryesisë, të katër seksioneve të Akademisë dhe të shërbimeve administrative profesionale e teknike). Pas diskutimeve që u bënë, u sugjerua që të evitohen disa lëshime teknike dhe gjuhësore dhe pastaj Raporti t'i kalohet për miratim Kuvendit të Akademisë; u miratuan nga Kryesia programet e punës së seksioneve, të cilat, në fakt, përbëjnë Programin e punës së ASHAK-ut, për vitin 2005. Programi, pas disa përmirësimeve teknike e gjuhësore, do t'i kalohet për miratim Kuvendit të Akademisë. Kryesia, njëherësh, konkludoi se pikat që vijnë nga bashkëpunimi ndërakademik janë pjesë përbërëse të Programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2005; Kryesia shqyrtoi propozimin e Vendimit për themelimin e Qendrës

Leksikografike-Enciklopedike të ASHAK-ut dhe propozimin e Rregullores së Punës së Qendrës Leksikografike-Enciklopedike. U vendos që pas disa korigjimeve të natyrës gjuhësore dhe teknike, propozimet e këtyre dy akteve do t'i dërgohen për miratim Kuvendit të Akademisë; Kryesia vendosi ta thërrasë mbledhjen LVIII të Kuvendit të Akademisë më 25 shkurt 2005, ora 11⁰⁰.

Kryesia e Akademisë mori edhe këto vendime:

a) Të shënohet 600-vjetori i lindjes së Skënderbeut, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, në Tiranë dhe në Prishtinë. Për këtë qëllim janë vënë kontaktet edhe me Institutin e Historisë të Kosovës. Përmasat e shënimit do të harmonizohen edhe me institucionet përkatëse që na rrethojnë;

b) Të shënohet 30-vjetori i themelimit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

a-1. U ngrit Këshilli i përgjithshëm për shënimin e këtij përvjetori me këtë përbërje:

Akademik Rexhep Ismajli, kryetar
Akademik Besim Bokshi, anëtar
Akademik Hivzi Islami, anëtar
Akademik Eqrem Basha, anëtar
Akademik Ekrem Murtezai, anëtar
Akademik Muharrem Berisha, anëtar
Akademik Rauf Dhomi, anëtar
Akademik Idriz Ajeti, anëtar
Akademik Jashar Rexhepagiq, anëtar
Akademik Minir Dushi, anëtar
Akademik Mark Krasniqi, anëtar
Zija Bylykbashi, anëtar.

Këshilli zgjedh Komisionin organizativ, i cili do të merret me organizimin dhe operacionalizimin e shënimit të këtij përvjetori.

b-1. Kryesia ngriti Redaksinë për përgatitjen e botimit të librit, që botohet me rastin e 30-vjetorit të ASHAK-ut, me këtë përbërje:

Akademik Hivzi Islami,
Akademik Eqrem Basha,
Mr. Zija Bylykbashi.

c) Kryesia sugjeroi të mblidhet Redaksia e revistës *STUDIME* për të diskutuar shkallën e përgatitjes për botim të numrit vijues.

ç) Kryetari i Akademisë e informoi Kryesinë për vizitën e z. Naim Tërnavës, myfti i Kosovës, me bashkëpunëtorët e tij, në Akademi. Me këtë rast është diskutuar edhe mundësia e bashkëpunimit në fushën e terminologjisë islame. Ka pasuar shkresa zyrtare e Bashkësisë Islame të Kosovës nr. 24/05 dt. 24/01/06, me të cilën, ndër të tjera, kërkohet të mbahet një tryezë apo sesion shkencor me temë: “Unifikimi i terminologjisë fetare”, në të cilën do të merrnin pjesë studiues nga Prishtina, Tirana, Shkupi, Podgorica e nga mërgata.

Kryesia vendosi t’ia kalojë për shqyrtim shkresën në fjalë Seksionit të Shkencave Shoqërore, nga i cili pret përgjigjen.

3. Mbledhja e radhës e Kryesisë së Akademisë (XXIX) u mbajt më 2 shkurt.

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes XXVIII të Kryesisë; shqyrtoi Raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2004 dhe vendosi t’ia kalojë për miratim Kuvendit të Akademisë; mori vendim të pranohet në marrëdhënie pune ose të angazhohet me kontratë mbi veprën një **kontabilist (ekspert financiar)**; vendosi t’i propozojë Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë për anëtarë të mundshëm të komisioneve:

1) për hartimin e **Udhëzimit Administrativ për caktimin e standardeve për hulumtime shkencore**, dhe

2) hartimin e **Udhëzimit Administrativ për themelimin e Këshillit Kombëtar të Shkencës (KKSH) të Kosovës** nga këta anëtarë të ASHAK-ut:

akademikët Besim Bokshi, Ekrem Murtezai, Eqrem Basha, Hivzi Islami, Muharrem Berisha dhe anëtari korrespondent Latif Susuri; i sugjeroi Seksionit të Shkencave Shoqërore që, në mbledhje formale, ta shqyrtojë shkresën e BIK-ut lidhur me organizimin e një tryeze shkencore me temë nga fusha e terminologjisë islame.

4. Në mbledhjen e 27 prillit, Kryesia miratoi procesverbalin e mbledhjes XXIX; pas shqyrtimit në seksionet e Akademisë dhe pas përfshirjes së shumicës së vërejtjeve të seksioneve nga Komisioni për harmonizimin e Statutit me Ligjin e ASHAK-ut, Kryesia shqyrtoi nen për nen Projektstatutin dhe i bëri propozimet, të cilat do t’i kalohen Kuvendit të Akademisë për miratim; mori vendim për shlyerjen nga

evidenca të mjeteve themelore të Akademisë, për shkak të amortizimit të tyre, me të cilat do të merret një komision i posaçëm, i cili do të hartojë raport me shkrim për veprimet e bëra lidhur me to; mori vendim që anëtarëve të jashtëm të Komisionit për çështje të shqipes standarde t'u paguhen nga 50 € për pjesëmarrje në mbledhjet e Komisionit dhe për kontributin e tyre në hartimin e tekstit **Orientime për punën e Komisionit për çështje të shqipes standarde**; mori vendim të blihen mjete themelore kompjuterike dhe orendi e të tjera; sekretarët e seksioneve të Akademisë morën përsipër obligimin që deri në fund të majit t'i miratojnë programet e tyre të punës për vitin 2006.

5. Mbledhja XXXI e Kryesisë së Akademisë e 9 qershorit, pas shqyrtimit të pikave të rendit të ditës, vendosi: ta miratojë procesverbalin e mbledhjes XXX; pas diskutimeve dhe sugjerimeve që u dhanë, Kryesia i propozon Kuvendit të Akademisë Programin e punës së ASHAK-ut për vitin 2006; ta delegojë Eqrem Bashën në Këshillin e Muzeut të Kosovës; miratoi raportin me shkrim të Kryetarit të Akademisë për pjesëmarrjen e tij në Takimin Bienal të Rrjetit Ndërkombëtar Ndërakademik për të Drejtat e Njeriut në Londër (17-22 mars 2005). Gjatë kësaj vizite u nënshkrua edhe Memorandumi i mirëkuptimit për bashkëpunim midis Akademisë Britanike dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në fushat e shkencave humane dhe shoqërore; miratoi raportin me shkrim të akademikëve H. Islami e E. Basha, për pjesëmarrjen e tyre në tubimin shkencor mbajtur në Amsterdam të Holandës (19-20/05.05) me temë bosht "*Vlerat e përbashkëta në hapësirën kërkimore evropiane*", organizuar nga ALLEA, në bashkëpunim me Academia Europaea dhe EuroScience; miratoi edhe raportin me shkrim të akademikëve R. Ismajli e B. Bokshi për pjesëmarrjen e tyre dhe të përfaqësuesve nga Kosova në mbledhjen e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe (Tiranë, 3 qershor 2005); ta thërrasë Mbledhjen LIX të Kuvendit të Akademisë më 29 qershor 2005, ora 10⁰⁰; në kuadër të pikës "çështje vijuese" Kryesia konkludoi, si më poshtë: a) U sugjerohet seksioneve që për fusha të caktuara të shkencave apo të arteve të ngrenë këshilla përkatëse, b) anëtarëve të Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe t'u paguhet honorari përkatës. Shuma e honorarit do të përcaktohet më vonë, c) ngriti Komisionin për përgatitjen e propozimit për shënimin e

600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut me këtë përbërje: H. Islami, kryetar dhe P. Nushi e Y. Jaka, anëtarë. Komisioni do t'i raportojë Kryesisë, në mbledhjen e ardhshme, për përgatitjet që janë bërë; ngriti Komisionin për vlerësimin e gjendjes funksionale të kompjuterëve të nxjerrë jashtë përdorimit, me këtë përbërje: H. Islami, kryetar, dhe Z. Bylykbashi e V. Fetahu, anëtarë. Komisioni do të vendosë edhe për fatin e kompjuterëve; dhe ç) se më 17 qershor 2005 do të përurohet vepra në 4 vëllime e Selman Rizës. Në përrurim, përveç të tjerëve, do të ftohet edhe Ylli Popa, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

6. Kryesia e Akademisë mbajti mbledhjen XXXII, më 14 korrik, në të cilën miratoi procesverbalin e mbledhjes XXXI të Kryesisë së Akademisë; orarin e kujdestarisë të punonjësve të Shërbimeve Administrative, Profesionale dhe Teknike të ASHAK-ut për periudhën e pushimit vjetor për vitin 2005 (25/07-26-08/2005); Kryetari Ismajli informoi Kryesinë se më 21 shtator 2005 vjen për vizitë nënkryetari i Akademisë Britanike prof. Nicholas Mann, i shoqëruar nga bashkëpunëtorja për marrëdhënie me jashtë e Akademisë Britanike, zonja Jane Lyddon's; Kryesia u informua se kryetari Ismajli do t'i dërgojë një ftesë për ta vizituar Akademinë tonë kryetarit të Akademisë së Gëtingenit; do të ftohet për vizitë në Akademinë tonë edhe prof. Torsten Visel, kryetar i Këshillit Ndërakademik për të Drejtat e Njeriut, me ç'rast ai do të mbante një ligjëratë para anëtarëve të Akademisë; Kryesia vendosi të botohet një libër me piktura dhe skulptura të anëtarëve të ASHAK-ut, i ngjashëm me katalogun "Artistët akademikë". Për përgatitjen e librit u ngrit redaksia me këtë përbërje: Rauf Dhomi, Eqrem Basha dhe Rexhep Ferri (U sugjerua që libri të përgatitet sa më parë që të jetë e mundur).

7. Në mbledhjen e 29 korrikut ((XXXIII), Kryesia miratoi tekstin e Kumtesës së Kryesisë së ASHAK-ut lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës dhe vendosi ta botojë një përmbledhje me akte të nxjerra nga Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë periudhës 2 korrik 1990 – 2 maj 1992, si dhe zgjodhi redaksinë për përgatitjen e kësaj përmbledhjeje me këtë përbërje: Rexhep Ismajli, Hivzi Islami dhe Iljaz Ramajli.

8. Mbledhja e radhës (XXXIV) e Kryesisë u mbajt më 20 shtator. Ajo miratoi procesverbalet e mbledhjeve XXXII e XXXIII të

Kryesisë së Akademisë; vendosi ta thërrasë Kuvendin zgjedhor për zgjedhjen e Kryesisë së re të ASHAK-ut më 8 nëntor 2005, ora 10⁰⁰; mori vendim që 30-vjetori i themelimit të ASHAK-ut të shënohet më 21 tetor 2005, në Hotelin “Grand” të Prishtinës. Këshilli i punës për shënimin e këtij përvjetori do të merret me organizimin konkret të veprimeve përkatëse;

Kryetari i Akademisë informoi Kryesinë për problemet lidhur me shpërblimet për anëtarët, për Kryesinë dhe për pagat e punonjësve të Akademisë si dhe për çështjen e godinës së re të Akademisë. Kemi bërë përpjekje të shumta dhe kemi pasur kontakte me personalitetet udhëheqëse të Kosovës, bile para disa ditësh edhe me z. Petersen. Përpjekjet do të vazhdojnë deri në zgjidhjen përfundimtare të tyre.

9. Kryesia e Akademisë, në mbledhjen e 31 tetorit (XXXV), pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes XXXIV të Kryesisë, i shqyrtoi raportet e seksioneve mbi rezultatet e votimeve për Kryesinë e re të Akademisë dhe miratoi pasqyrën e propozimeve të seksioneve të ASHAK-ut për Kryesinë e Akademisë.

10. Mbledhja I, pas zgjedhjes së Kryesisë së re (e dhjeta e këtij viti), u mbajt më 22 nëntor. Pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes XXXV, Kryesia miratoi Raportin e akademikëve R. Ismajli, B. Bokshi dhe I. Ajeti për udhëtimin e tyre në Shqipëri (17-19 nëntor 2005) dhe vendosi që ekspertëve të Institutit Mesdhetar Agronomik të Barit-Itali dr. Arben Myrta dhe Michele Digiaro, të ftuar nga ASHAK-u për ligjërata nga fusha e agronomisë, t’u paguhen shpenzimet e udhëtimit në shumë prej 842 eurosh, përmes transferit bankar, nga mjetet financiare të zotëruara për këtë destinim.

11. Mbledhja e fundit e Kryesisë së Akademisë (II) u mbajt më 29 dhjetor dhe pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja I, Kryesia shqyrtoi kërkesën e OJQ-së “URA” të Prizrenit me të cilën kërkohet themelimi i Këshillit Kombëtar për Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe i ngarkoi Kryetarin, Sekretarin e përgjithshëm dhe Sekretarin e Akademisë, ta hartojnë përgjigjen; e autorizoi Sekretarin e Akademisë ta nënshkruajë Memorandumin e Mirëkuptimit me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave për menaxhimin e mjeteve të ASHAK-ut (nga shitja e botimeve të saj) për vitin 2006; dhe në bazë të nenit 24 të Ligjit për Akademinë e

Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe nenit 35 të Statutit të ASHAK-ut mori vendim si më poshtë:

I. Shuma e shpërblimit mujor për anëtarin e rregullt (akademik) caktohet në nivelin e pagës të profesorit ordinar të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht **501 €**.

II. Shuma e shpërblimit mujor për anëtarin korrespondent caktohet në nivelin e pagës të profesorit të asociuar të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht **414 €**.

III. Shuma e shpërblimit mujor për anëtarët e Kryesisë caktohet:

- për Kryetarin e Akademisë	285 €
- për Nënkyetarin e Akademisë	210 €
- për Sekretarin e përgjithshëm të Akademisë	210 €
- për sekretarët e seksioneve (4 seksione) secilit nga	145 €

IV. Paga mujore për Sekretarin e Akademisë caktohet në nivelin e pagës mujore të Sekretarit të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht në shumën prej **370 €**.

Kryesia e Akademisë ka botuar edhe këta libra:

1. *“30 vjet të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës”*;
2. *“Artistët akademikë”*;
3. *“Akte të Kuvendit të Kosovës”*;
4. *“Statusi i ardhshëm i Kosovës”*.

III. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, gjatë vitit 2005, ka punuar sipas programit të punës të propozuar nga Seksioni dhe të aprovuar nga Kuvendi i ASHAK si dhe sipas kërkesave të tjera gjatë vitit, që e plotësonin këtë program. Seksioni ka mbajtur nëntë mbledhje, në të cilat janë shqyrtuar çështje të ndryshme të punës dhe veprimtarisë së rregullt, janë përgatitur dhe janë diskutuar pjesë të programit, dokumente të Akademisë, janë ngritur grupe punuese, recensues të botimeve, apo edhe kërkesa të tjera, që shtrinin organet e ASHAK-ut.

Shikuar në tërësi, veprimtaria e Seksionit, ashtu si edhe e tërë ASHAK-ut, gjatë vitit që lamë pas, ka qenë e pasur me botime, tryeza e konferenca shkencore, ligjërata, përrurime, etj.

Vlen të përmendet realizimi i përpiktë nga SGJL i obligimeve që dalin nga Protokollu i bashkëpunimit me ASHSH (të nënshkruar në shkurt 2002 në Tiranë), e kjo nuk mund të thuhet për pjesën që duhej të realizohej nga pala tjetër.

VEPRIMTARIA BOTUESE:

Plani botues i Seksionit është realizuar pothuajse në tërësi, me pak përjashtime. Ky plan është tejkaluar me veprën e Ali Aliut. Në përgjithësi, nën përkujdesjen e Seksionit janë realizuar këto botime:

1. Rexhep Ismajli, *DREJTSHKRIMET E GJUHËS SHQIPE*;
2. Sabri Hamiti, *TEMATOLOGJIA*;
3. *FJALORI I TERMAVE TË INFORMATIKËS*;
4. Besim Bokshi, *RRUGA E FORMIMIT TË FLEKSIONIT TË SOTËM NOMINAL TË SHQIPES* (ribotim);
5. Ali Aliu, *DON KISHOTI TE SHQIPTARËT*;
6. *RRJEDHAT E LETËRSISË BASHKËKOHORE SHQIPTARE / Nga gjysma e dytë e shekullit XX – poezia, proza dhe drama*, (materialet e Simpoziumit);
7. *KONFERENCA SHKENCORE PËR FAIK KONICËN* (materialet e Konferencës);
8. REVISTA ‘STUDIME’ 11.

Nga ato që figuronin në planin botues për vitin 2005 nuk janë realizuar:

- Materialet e simpoziumit “*Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare II*” (Kritika letrare dhe Historia e letërsisë), që duhej të organizohej nga IGJL i ASHSH - ngase ky simpozium nuk është mbajtur;

- Materialet e tryezës shkencore “*Vepra e Selman Rizës*”, që duhej të përgatitej nga IGJL i ASHSH - sepse tryeza nuk është organizuar;

- Vepra e Idriz Ajetit “*Për historinë e albanistikës*” është në realizim e sipër dhe pritet të kryhet brenda vitit 2006;

- Numri 12 i revistës *Studime*, që parashihej për këtë vit, është në përgatitje e sipër dhe pritet të dorëzohet së shpejti në shtyp.

PROJEKTE DHE VEPRIMTARI TË TJERA SHKENCORE

- Këshilli Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe është ngritur me vendimin e ASHAK dhe ASHSH të datës 27 tetor 2004. Siç thuhet në Rregulloren e punës, Këshilli... është forum gjuhëtarësh që shqyrton probleme të përgjithshme e të veçanta të shqipes standarde dhe të funksionimit të saj në gjithë hapësirën e përdorimit të gjuhës shqipe. Ai ka 17 anëtarë dhe drejtohet nga dy bashkëkryetarë, Shaban Demiraj nga ASHSH dhe Rexhep Ismajli nga ASHAK.

Nga ASHAK anëtarë të këtij Këshilli janë: Rexhep Ismajli, Besim Bokshi, Idriz Ajeti, Imri Badallaj, Shefkije Islamaj, Isa Bajçinca dhe Abdullah Zymberi. Nën përkujdesjen e ASHAK është edhe pjesëmarrja e Remzi Nesimit, anëtar i këtij Këshilli nga Maqedonia.

Këshilli ka hartuar dhe aprovuar Rregulloren e punës, sipas së cilës gjatë vitit 2005 kryesia e tij ka qenë në Tiranë, kurse ASHAK e merr kryesinë në Prishtinë gjatë vitit 2006.

Më 26 maj 2005, është mbajtur mbledhja e Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe, pjesa e Kosovës, ku janë propozuar komisionet studimore për: Çështjet e drejtshkrimit (F. Raka, F. Çitaku, Z. Munishi); Transkriptimi i fjalëve nga gjuhët e huaja (V. Nuhiu, I. Ajeti, N. Caka); Probleme të normës morfologjike (B. Bokshi, R. Mulaku, Rr. Paçarizi); Probleme të normës sintaksore dhe të pikësimit

(I. Bajçinca, S. Ahmetaj, H. Mujaj, L. Rugova); Probleme të leksikut e të normës leksikore (Sh. Islamaj, A. Zymberi, Q. Murati, B. Rugova); Probleme të formimit gjuhësor në shkollë (I. Badallaj, Z. Munishi, H. Devetaku), ndërsa më 3 qershor 2005 është mbajtur në Tiranë mbledhja e Këshillit në përbërje të plotë, në të cilën është vendosur themelimi i komisioneve hulumtuese si më lart, me propozimet edhe të anëtarëve të komisioneve nga pala e ASHSH-së.

Grupet e punës të delegacionit të Kosovës në Këshill janë takuar veç e veç në Prishtinë dhe kanë dhënë një sërë propozimesh.

Takimi i dytë i Këshillit është mbajtur gjithashtu në Tiranë më 19. 11. 2005. Në të pala e Kosovës ka sjellë raportet e grupeve të punës për çështje të drejtshkrimit, për leksik dhe terminologji, për fjalë të huaja, derisa delegacioni nga Shqipëria një raport për çështje të drejtshkrimit.

- **Tryeza shkencore me rastin e 450-vjetorit të botimit të “Mesharit” të Gjon Buzukut** është mbajtur më 17 mars në mjediset e Akademisë. Në të kanë mbajtur kumtesa: Rexhep Ismajli, Idriz Ajeti, Wilfried Fiedler, Seit Mansaku, Imri Badallaj, Kolec Topalli, Bardhyl Demiraj (kumtesa është dërguar me postë), Ragip Mulaku dhe Besim Bokshi.

- **Tryeza shkencore “Komunikimet letrare në botën shqiptare”** është mbajtur më 30 mars 2005 në mjediset e Akademisë. U paraqitën me kumtesa: Ali Aliu, Kristaq Jorgo, Mehmet Kraja, Nazmi Rrahmani, Ali Podrimja, Sabri Hamiti, Agron Tufa, Kim Mehmeti, Sadik Bejko, Enver Gjerqeku.

- **Përrurimi i veprës së Selman Rizës**, në katër vëllime, botuar nga ASHAK, është organizuar në lokalet e Akademisë më 17 qershor 2005 dhe me atë rast për jetën dhe veprën e S. Rizës folën: Rexhep Ismajli, Idriz Ajeti, Besim Bokshi dhe Fahrudin Hoxha, nënkryetar i ASHSH.

- **Konferenca shkencore për Faik Konicën**, e organizuar nga ASHAK dhe ASHSH, u mbajt në lokalet e ASHAK më 8 dhjetor 2005. U paraqitën me kumtesa: Ali Aliu, Sabri Hamiti, Jorgo Bullo,

Luan Starova, Alfred Uçi, Kujtim Shala, Floresha Dado, Remzi Përnaska, Fatmir Sulejmani, Basri Çapriqi, Kristaq Jorgo, Mehmet Kraja, Hamit Xhaferi, Agron Tufa, Sali Bashota.

Nga veprimtaria shkencore e paraparë për vitin 2005, që del nga Protokollu i bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH, nuk janë realizuar:

- Vazhdimi i punës në projektin “Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare – Kritika letrare dhe historia e letërsisë;
 - Tryeza shkencore për veprën e Selman Rizës;
 - Konferenca shkencore kushtuar veprës së Anton Pashkut;
- Të tri këto projekte kanë qenë obligim i ASHSH-së.

Sa iu përket detyrave të Seksionit, që dalin nga Protokollu, janë realizuar që të gjitha.

TË TJERA

- Anëtarët e ASHAK-ut, Rexhep Ismajli, Besim Bokshi dhe Idriz Ajeti, kanë marrë pjesë në Konferencën shkencore për 450-vjetorin e “*Mesharit*” të Buzukut, të organizuar nga ASHSH në Tiranë më 18 nëntor 2005.

Menjëherë pas kësaj konference në Tiranë, ASHSH promovoi veprën e Idriz Ajetit, *Studime dialektologjike dhe etimologjike*, botuar nga ASHSH, dhe atë të Wilfried Fiedler-it, *Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555)*, botuar nga ASHAK. Për veprën e parë folën Shaban Demiraj, Rexhep Ismajli, Besim Bokshi, Gjovalin Shkurtaj dhe autori Idriz Ajeti, kurse për veprën e Fiedler-it, Shaban Demiraj, Rexhep Ismajli, Emil Lafe, Ethem Likaj, Koleç Topalli dhe autori Wilfried Fiedler.

- Rexhep Ismajli, Besim Bokshi dhe Ali Aliu, kanë marrë pjesë edhe në Konferencën shkencore për 450-vjetorin e “*Mesharit*” të Buzukut në Tetovë, të organizuar nga Universiteti i Evropës Juglindore, ndërsa në Konferencën shkencore me rastin e 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut në Shkup morën pjesë Besim Bokshi, Ali Aliu dhe Ali Podrimja.

- Në aktivitetet e SGJL duhen përmendur edhe vizitat dhe ligjëratat e dy albanologëve të shquar amerikanë, Eric P. Hamp dhe

Wictor Friedman, anëtarë të jashtëm të ASHAK. Të parit iu dorëzua fletëdëshmia e anëtarit të jashtëm të ASHAK më datë 7 tetor 2005. Me atë rast ai foli për interesimet dhe kontributet e tij për shqipen. Victor Friedman-it më 23 nëntor 2005 iu dorëzua fletëdëshmia e anëtarit të jashtëm të ASHAK kur ai mbajti ligjëratën “Gjuha shqipe, gjuhësia ballkanike dhe ballkanizimi i Ballkanit”.

Ka pasur edhe shumë aktivitete të tjera shkencore të anëtarëve të SGJL jashtë programeve të ASHAK-ut. Do përmendur këtu ligjëratat e Rexhep Ismajlit dhe Besim Bokshit në Universitetin e Tiranës, ligjëratën e Rexhep Ismajlit në Universitetin e Kalabrisë në Kozencë, fjalët e Rexhep Ismajlit dhe Sabri Hamitit në promovimin e veprave të Ibrahim Rugovës në Tiranë, ligjëratat e Rexhep Ismajlit, Sabri Hamitit, në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare për të Huaj në Prishtinë, si dhe shumë pjesëmarrje në aktivitete shkencore, programe kulturore, etj. Botimet e anëtarëve të SGJL janë realizuar edhe nga shtëpi të tjera botuese në Kosovë e Shqipëri, ndërsa Mehmet Kraja ka marrë çmimin “Azem Shkreli” të MKRS për veprën më të mirë të botuar gjatë vitit 2004.

VEPRIMTARIA ZGJEDHORE

Tetori ka qenë muaji i propozimeve për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë. Fillimisht, me 20 tetor, Seksioni ka propozuar për kryetar të ASHAK Rexhep Ismajlin, për nënkryetar Besim Bokshin, për sekretar të përgjithshëm Hivzi Islamin, ndërsa për sekretar të SGJL Eqrem Bashën. Procedurat kanë qenë të rregullta dhe në përputhje me Statutin e ASHAK. Pastaj, në mbledhjen e radhës, më 31 tetor 2005, është bërë përcaktimi përfundimtar i propozimeve të Seksionit për funksionet e caktuara në Kryesinë e Akademisë. Kandidatët kanë marrë shumicën e nevojshme të votave, e këto propozime i kanë kaluar Kuvendit të ASHAK, në të cilin janë zgjedhur kryetari, nënkryetari dhe sekretari i përgjithshëm i ASHAK dhe është konfirmuar zgjedhja e sekretarit të SGJL.

IV. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

Sikurse edhe gjatë vitit të mëparshëm 2004, ashtu edhe gjatë vitit 2005, puna e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe e anëtarëve të tij është zhvilluar në përputhje të plotë me programin e punës së tij, të miratuar nga Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Sa i përket realizimit të programit të punës, si dhe çështjeve të ndryshme, që janë paraqitur ndërkohë e që nuk kanë që paraparë me programin e punës, Seksioni i Shkencave Shoqërore gjatë vitit 2005 i ka mbajtur 11 mbledhje, në të cilat janë shqyrtuar (përveç “çështjeve vijuese” dhe “miratimit të procesverbalit”) 27 çështje nga më të ndryshmet.

Në mbledhjen e parë të Seksionit të Shkencave Shoqërore, të mbajtur më 17 janar 2005, është shqyrtuar dhe miratuar raporti i punës për vitin 2004, është miratuar programi i punës për vitin 2005 dhe janë caktuar recensuesit për vlerësimin e dorëshkrimit të akademik Hivzi Islamit “*Studime demografike*”.

Në mbledhjen e dytë, të mbajtur më 3 shkurt 2005, është shqyrtuar letra e Bashkësisë Islame të Kosovës, në të cilën propozohej të mbahet një tryezë e përbashkët shkencore kushtuar terminologjisë islame, është marrë vendimi të bëhet përrurimi i veprës së akademik Gazmend Zajmit dhe është miratuar dorëshkrimi i akademik Hivzi Islamit.

Mbledhja e tretë e Seksionit u mbajt më 2 mars 2005 dhe në të është formuar Këshilli organizues i Tryezës shkencore kushtuar terminologjisë islame dhe është caktuar dita e përrurimit të veprës së akademik Gazmend Zajmit.

Seksioni mbajti një mbledhje të veçantë (më 5 prill 2005) kushtuar shqyrtimit të Projektstatutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në të cilën u dhanë vërejtje e sugjerime në lidhje me Statutin në fjalë.

Më 5 maj 2005, është mbajtur mbledhja e Seksionit, në të cilën janë shqyrtuar përgatitjet për programin e punës së këtij seksioni për vitin 2006 dhe janë caktuar recensuesit për vlerësimin e dorëshkrimit të akademikut Jashar Rexhepagiq “*Sami Frashëri dhe pedagogjia e Rilindjes Kombëtare*” (akademik Rexhep Qosja dhe anëtari

korrespondent Pajazit Nushi). Po në këtë mbledhje, u propozua dhe u vendos të shënohet 200-vjetori i ardhjes në pushtet i Mehmet Ali Pashës.

Në mbledhjen e Seksionit të Shkencave Shoqërore, që u bë më 25 maj 2005, u miratua Programi i punës për vitin 2006 dhe vlerësimi i dorëshkrimit të akademikut Jashar Rexhepagiq “*Sami Frashëri dhe pedagogjia e Rilindjes Kombëtare*”.

Në bazë të sugjerimit të kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Rexhep Ismajlit, më 23 qershor 2005 u mbajt mbledhja Seksionit të Shkencave Shoqërore, në të cilën u vendos të organizohet një tryezë shkencore me temë “Statusi i Kosovës dhe bisedimet”.

Po në këtë mbledhje Seksioni ngriti redaksionë për botimin e një vepre të Aleks Budës me këtë përbërje: Hivzi Islami, Fehmi Rexhepi dhe Tatjana Haxhimihali.

Në mbledhjen e Seksionit të Shkencave Shoqërore, që u bë më 27 shtator 2005, anëtarët e këtij seksioni u informuan për zgjedhjet e Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe u caktuan rencensuesit për vlerësimin e dorëshkrimit të akademik Esat Stavileci “*Nocione dhe parime të administratës publike...* (Akademik Ekrem Murtezai dhe prof.dr. Bajram Pollozhani), si dhe të dorëshkrimit të prof. dr. Muhamedin Kullashit” (akademik Ekrem Murtezai dhe akademik Esat Stavileci).

Më 1 nëntor 2005, u mbajt mbledhja e Seksionit të Shkencave Shoqërore, në të cilën u bë përcaktimi përfundimtar për anëtarë të Kryesisë së ASHAK-ut dhe u bë votimi i fshehtë, i cili dha këtë rezultat: kryetar akademik Rexhep Ismajli (6 vota), nënkryetar akademik Besim Bokshi (6 vota) dhe sekretar i përgjithshëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës akademik Hivzi Ismajli (6 vota), kurse sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore u zgjodh akademik Ekrem Murtezai (5 vota). Në këtë mbledhje u diskutua edhe për dorëshkrimin e akademik Ali Hadrit me titull “*Gjergj Kastrioti – Skënderbeu dhe epoka e tij*”. Lidhur me këtë anëtarët e Seksionit bënë vërejte se duhet ndryshuar titulli i dorëshkrimit dhe të përfshihet vetëm materiali që ka të bëjë me Skënderbeun.

Mbledhja e fundit e Seksionit të Shkencave Shoqërore për vitin 2005 u bë më 19 dhjetor 2005, në të cilën u vendos të formohen dy këshilla si trupa punues të këtij seksioni: Këshilli për histori (akademik Ekrem Murtezai (kryesues), dr. Jusuf Bajraktari, dr. Fehmi Rexhepi, prof. dr. Emine Bakalli, dhe prof. dr. Gazmend Riza, prof. dr. Edi Shukriu dhe dr. Shkelzen Raça) dhe Këshilli për ekonomi (akademik Hivzi Islami (kryesues), prof. dr. Skënder Berisha, prof. dr. Ali Jakupi, prof. dr. Haki Dushi, prof. dr. Skënder Ahmeti, prof. dr. Muhamet Mustafa dhe prof. dr. Isa Mustafa). Vendimi i Seksionit të Shkencave Shoqërore, që ka të bëjë me formimin e këtyre dy këshillave është i determinuar me faktin se në këtë seksion nuk ka ekspertë për këto fusha shkencore.

Në përputhje me programin e punës gjatë vitit 2005 janë përgatitur, vlerësuar dhe botuar këto vepra: vepra e akademik Hivzi Islamit “*Studime demografike*”, vepra e akademik Jashar Rexhepagiqit “*Sami Frashëri dhe pedagogjia e Rilindjes Kombëtare*”, vepra e akademik Esat Stavilecit “*Nocione dhe parime të administratës publike*”, vepra e prof. dr. Muhamedin Kullashit “*Mendimi politik modern*”, si dhe vepra e akademik Mark Krasniqit “*Mikpritja në traditën shqiptare*”. Përveç këtyre, është botuar edhe materiali nga Tryeza shkencore “*Statusi i Kosovës dhe bisedimet*”, i cili nuk ka qenë i paraparë me program, por të cilin e ka kërkuar momenti politik, në të cilin gjendet Kosova.

Gjatë vitit 2005, Seksioni i Shkencave Shoqërore i ASHK-ut ka organizuar përrurimin e veprës së akademik Gazmend Zajmit, ka shënuar 200-vjetorin e ardhjes së Mehmet Ali Pashës në krye të Egjiptit, sikurse, së bashku me Fakultetin e Studimeve Islame, Fakultetin Filologjik dhe Institutin Albanologjik të Prishtinës, tryezën shkencore “*Terminologjia islame*”, në të cilën kanë marrë pjesë gjuhëtarë, teologë dhe teoricienë të ndryshëm jo vetëm nga e tërë Kosova, por edhe nga Shqipëria dhe Maqedonia. Tryeza ishte e suksesshme.

Tërë kësaj duhet shtuar faktin se gjatë vitit 2005 anëtarët e Seksionit të Shkencave Shoqërore morën pjesë aktive në shumë tubime shkencore e të tjera, siç janë Simpoziumi shkencor kushtuar “*600-vjetorit të lindjes së Gjergj Kastriotit – Skënderbeut*”, të cilin e organizuan Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe

Instituti i Historisë i Prishtinës, pastaj Simpoziumi, që me këtë rast u mbajt në Shkup, ku mori pjesë anëtari i këtij Seksioni Hivzi Islami, Tiranë, në të cilin në emër të ASHAK-ut mori pjesë Pajazit Nushi etj. Sikurse edhe Simpoziumi dedikuar jetës dhe veprës së Sami Frashrit, që u mbajt në Shkup, Sesionin shkencor dedikuar 20-vjetorit të përkthimit të *Kur'anit* në gjuhën shqipe, të cilin e organizoi Bashkësia Islame e Kosovës etj. E tërë kjo flet për një punë të madhe e të rëndësishme, të cilën gjatë vitit 2005 e kanë bërë Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe anëtarët e tij veç e veç.

Anëtarët e Seksionit të Shkencave Shoqërore janë autorë të shumicës së punimeve të botuara në numrin XI të "*Studimeve*".

V. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Seksioni i Shkencave të Natyrës, gjatë vitit 2005, ka punuar sipas Programit të punës së Seksionit, të miratuar në Kuvendin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të mbajtur më 25.2.2005.

Gjatë vitit 2005, Seksioni i Shkencave të Natyrës është takuar nëntë herë. Në shumicën e mbledhjeve të veta, Seksioni ka shqyrtuar realizimin e programeve të punës së Seksionit. Për të pasur një pasqyrë sa më të qartë, në vijim po e paraqesim programin e Seksionit, të paraparë të realizohet në vitin 2005:

I. Projekte shkencore:

1. Vazhdimi i Projektit: **Fjalori i termave të botanikës** (në bashkëpunim me ASHSH – Institutin e Kërkimeve Biologjike në Tiranë);

2. Projekti: **Monitorimi i radioaktivitetit në mjedis, për analizat e përcaktimit të izotopeve radioaktive në mostra mjedisore dhe teknologjike, etj.** (ASHSH (IFB) në bashkëpunim me Departamentin e Fizikës në FSHMN).

II. Botimet:

1. Grup autorësh: **Fjalori terminologjik i informatikës** (në bashkëpunim me Seksionin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë);

2. Latif Susuri, **Fjalori: bimë dëmtues – patogjenë;**

3. Minir Dushi: **Botim i veçantë: Zhvillimi i shkencave të xehetarisë dhe të metalurgjisë në Kosovë (1970-2005);**

4. Revista: *Kërkime 13.*

Programi pothuajse në tërësi është realizuar sipas planit, por disa pjesë të tij (sidomos ato projekte të cilat janë paraparë të realizohen në bashkëpunim me institucione të tjera) nuk kanë mundur të realizohen në tërësi në këtë periudhë, më tepër për shkaqe objektive. Ato mbeten të realizohen në programin e punës për vitin 2006.

Gjatë vitit 2005, Seksioni i ka realizuar në tërësi këto projekte dhe botime:

I. Projektet:

1. **Fjalori i terminologjisë së botanikës** (në bashkëpunim me ASHSH (IKB), FSHN dhe IGJL).

II. Botimet:

1. Minir Dushi: **Zhvillimi i shkencave të xehetarisë dhe të metalurgjisë në Kosovë (1970-2005)**;

2. Latif Susuri: **Fjalor, bimë, dëmtues, patogjenë**;

3. Grup autorësh: *Kërkime 13*.

Mund të konstatohet se është duke u vazhduar puna në:

I. Projektet shkencore:

1. **Fjalori shpjegues i terminologjisë së botanikës**;

2. Projekti: **Monitorimi i radioaktivitetit në mjedis, për analizat e përcaktimit të izotopeve radioaktive në mostra mjedisore dhe teknologjike, etj.** (ASHSH (IFB) në bashkëpunim me Departamentin e Fizikës në FSHMN).

II. Botimet:

1. Minir Dushi: **Veprimtaria kërkimore-shkencore në “Trepça”**- titull pune.

2. Latif Susuri: **Fjalori shumëgjuhësor i emrave të bimëve agronomike dhe dendrologjike**.

3. Grup autorësh: *Kërkime 14*.

Në këtë raport, në mënyrë kronologjike do të paraqiten çështjet që i ka shqyrtuar Seksioni i Shkencave të Natyrës gjatë vitit 2005, sipas mbledhjeve të mbajtura.

Në mbledhjen e parë, të mbajtur më 12 janar 2005, është shqyrtuar Raporti i punës së Seksionit për vitin 2004 dhe është miratuar Programi i punës për vitin 2005. Po ashtu është miratuar për botim numri 12 i revistës “*Kërkime*”.

Në mbledhjen e dytë të Seksionit, të mbajtur më 27 janar 2005, është plotësuar Programi i punës së Seksionit për vitin 2005.

Në mbledhjen e tretë, të mbajtur më 6 prill 2005, është shqyrtuar projekti i Statutit të ASHAK-ut dhe janë caktuar recensuesit për vlerësimin e dorëshkrimit të Minir Dushit: “*Zhvillimi i shkencave të xehetarisë dhe të metalurgjisë në Kosovë (1970-2005)*”. Po ashtu, në këtë mbledhje janë caktuar recensuesit për vlerësimin e dorëshkrimit të Latif Susuri: “*Fjalor – bimë, dëmtues dhe patogjen*”, si dhe janë

caktuar recensuesit për punimet e arritura deri më tani për revistën *Kërkime 13*.

Më 16 maj 2005, është mbajtur mbledhja e katërt e Seksionit, në të cilën është folur për përgatitjet për shqyrtimin e programeve të punës për vitin 2006 dhe është miratuar botimi i këtyre veprave:

1. Minir Dushi: *Zhvillimi i shkencave të xehetarisë dhe të metalurgjisë në Kosovë (1970-2005)*;

2. Latif Susuri: *Fjalor i mbrojtjes së bimëve* (titull pune).

Në mbledhjen e pestë, të mbajtur më 1 qershor 2005, është miratuar Programi i punës së Seksionit për vitin 2006, të cilin do ta paraqesim në vijim:

I. Projekte shkencore:

1. **Enciklopedia shqiptare** (në bashkëpunim me ASHSH) – projekt afatgjatë;
2. Hartimi i **Fjalorit shpjegues të termave të botanikës**;
3. **Monitorimi i radiaktivitetit në mjedis, për analizat e përcaktimit të izotopeve radioaktive në mostra mjedisore dhe teknologjike.**

II. Botime:

1. Minir Dushi: *Veprimtaria kërkimore-shkencore në “Trepça”* – titull pune.
2. Latif Susuri: *Fjalori shumëgjuhësor i emrave të bimëve agronomike dhe dendrologjike.*
3. Revista *Kërkime 14*.

Tryezë shkencore: **Hulumtimi i virozave bimore.**

Në mbledhjen e gjashtë, të mbajtur më 14 korrik 2005, janë caktuar recensuesit e punimeve të arritura për revistën “*Kërkime 13*”.

Më 18 tetor 2005, është mbajtur mbledhja e shtatë e Seksionit, në të cilën janë bërë propozimet për zgjedhjen e Kryetarit, Nënkyetarit, Sekretarit të përgjithshëm të ASHAK-ut dhe të sekretarit të Seksionit.

Në mbledhjen e tetë të Seksionit, të mbajtur më 2 nëntor 2005, është bërë përcaktimi përfundimtar i propozimeve për kryetar, nënkryetar dhe sekretar të përgjithshëm të ASHAK-ut, ndërsa në mbledhjen e fundit të nëntë, të mbajtur më 14 dhjetor 2005, janë shqyrtuar dy propozime të akad. Musa Haxhiut, për:

a) Vazhdimin e botimit të revistës shkencore “*Acta Biologiae et Medicinae Experimentalis*”;

b) Botimin e studimit monografik, që ka të bëjë me rolin e oksidit të azotit të autorëve M. A. Haxhiu, Muharrem Jakupi dhe Burim Neziri.

VI. SEKSIONI I ARTEVE

Seksioni i Arteve i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbështetur në Programin e punës të ASHAK, i cili është aprovuar në mbledhjen vjetore të Kuvendit të ASHAK, mbajtur më 29 qershor 2005, ka zhvilluar aktivitetet dhe ka paraqitur veprimtarinë e vet krijuese.

Gjatë vitit 2005, Seksioni i Arteve ka mbajtur gjithsej gjashtë (6) mbledhje dhe është përpjekur për ta realizuar planin e veprimtarisë së vet krijuese.

1. Në mbledhjen XII të Seksionit, mbajtur më 14 janar 2005, është miratuar procesverbali i mbledhjes XI të Seksionit; Raporti i punës së Seksionit për vitin 2004 dhe Programi i punës për vitin 2005.

Në mbledhje u shtrua çështja e pagimit të honorarit të autorit edhe për ekzekutimin e veprave në fushën e muzikës dhe për ekspozitat në fushën e arteve pamore dhe u konkludua:

- Seksioni të nisë iniciativën për realizimin e honorarit të autorit edhe në fushat e muzikës dhe të arteve pamore;

- Anëtarët e Seksionit morën përsipër të sigurojnë të dhëna për praktikantët e akademike të jashtme nga këto fusha.

2. Seksioni në Mbledhjen XIII të dt. 8 prill 2005, pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes XII, shqyrtoi Projektstatutin e ASHAK-ut nën për nen. Vërejtjet dhe sugjerimet do t'i kalohen Kryesisë së Akademisë.

3. Në këtë mbledhje (XIV) të Seksionit, të mbajtur më 9 maj 2005, u miratua procesverbali i mbledhjes XII dhe u informuan anëtarët me konkluzionin e Kryesisë së Akademisë se, deri në fund të majit 2005, seksionet e Akademisë duhet t'i miratojnë programet e punës për vitin 2006.

Anëtarët e pranishëm u zotuan t'i paraqesin propozimet e tyre eventuale për Programin e punës së Seksionit për vitin 2006 para mbledhjes së ardhshme të Seksionit, e cila u caktua të mbahet më 24 maj 2005.

4. Mbledhja XV e Seksionit të Arteve, mbajtur më 24 maj 2005, pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes XIV, miratoi Programin e punës për vitin 2006, me këtë përmbajtje:

PROJEKTE (Bashkë me ASHSH-në):

1. **Enciklopedia shqiptare** – projekt afatgjatë;
2. **Enciklopedia e artit shqiptar** – projekt afatgjatë.

BOTIME:

1. Rauf Dhomi: *Operë kamertale* (rreth 300 f.);
2. Engjëll Berisha: *Album për piano me veprat e akademikëve Rauf Dhomi e Zeqirja Ballata dhe kompozitorëve të tjerë të Kosovës.*

5. Në mbledhjen XVI të Seksionit, mbajtur më 27 tetor 2005, si zakonisht, në fillim u miratua procesverbal i mbledhjes paraprake, kurse në vazhdim Seksioni u mor me propozimet për zgjedhjen e Kryetarit, Nënkyetarit, Sekretarit të përgjithshëm dhe me zgjedhjen e sekretarit të Seksionit.

Në bazë të rezultateve të votimit, u konstatua se nga ky seksion janë zgjedhur këta kandidatë:

1. Kryetar, **Rexhep Ismajli**.
2. Për nënkryetar, Seksioni nuk ka kandidatë.
3. Sekretar i përgjithshëm, **Hivzi Islami**.
4. Sekretar i këtij seksioni u rizgjedh **Rauf Dhomi**.

Për funksionin e nënkryetarit është përsëritur votimi. Sipas rezultateve të votimit të përsëritur, asnjëri nga kandidatët e propozuar për funksionin e nënkryetarit të Akademisë nuk ka fituar numrin e duhur të votave, kështu që ky seksion nuk ka kandidat të vetin për funksionin e nënkryetarit të Akademisë.

6. Mbledhja XVII e Seksionit është mbajtur më 7 nëntor 2005. Është miratuar procesverbal i mbledhjes XVI dhe pastaj, duke u bazuar në pasqyrën e propozimeve të seksioneve të Akademisë për Kryesinë e Akademisë, anëtarët e Seksionit votuan për përcaktimin përfundimtar të propozimeve për kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin e përgjithshëm të ASHAK-ut.

Nga rezultatet e votimit del se nga ky seksion janë përcaktuar përfundimisht propozimet për:

1. Kryetar të Akademisë akad. Rexhep Ismajli;
2. Nënkyetar akad. Besim Bokshi;

3. Sekretar të përgjithshëm akad. Hivzi Islami.

Po në këtë mbledhje, Seksioni e miratoi për botim veprën e Rauf Dhomit *Dasma arbëreshe*, ndërsa redaktor i këtij botimi u caktua Engjëll Berisha.

Seksioni i ka realizuar këto pika të Programit të punës për vitin 2005:

1. Është realizuar Ekspozita retrospektive e Tahir Emrës në Tiranë;
2. Është botuar vepra e Rauf Dhomit *Dasma arbëreshe*;
3. Është dorëzuar në shtyp *Monografia* për Agim Çavdarbashën.

VII. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE

Shërbimet profesionale, administrative e teknike të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, gjatë vitit 2005, kanë pasur numër të njëjtë të punëtorëve, gjithsej 11. Ka vazhduar me kontratë mbi veprën angazhimi i mr. Lindita Rugovës, asistente në Degën e gjuhës angleze të Fakultetit të Filologjisë të Prishtinës, në vendin e punës: bashkëpunëtor për marrëdhënie ndërakademike dhe për veprimtarinë botuese të Akademisë. Edhe pse kryerja me sukses e punëve të sipërpërmendura kërkon orar të plotë të punës, znj. Lindita, për shkak të angazhimeve të saja në Fakultet, nuk është angazhuar edhe në punët e veprimtarisë botuese të Akademisë. Megjithatë, me angazhimin e saj, komunikimi me akademitë dhe institucionet e botës së jashtme ka vazhduar të jetë i kënaqshëm.

Vazhdojnë vështirësitë që shfaqen në procedurat e realizimit të buxhetit të Akademisë edhe për shkak se nuk kemi në marrëdhënie pune asnjë ekonomist – ekspert të çështjeve financiare. Për zgjidhjen e këtij problemi kanë vazhduar përpjekjet për punësimin e një eksperti të kësaj fushe ose për angazhimin e tij të kohëpaskohshëm (me kontratë mbi veprën).

Në Bibliotekën e Akademisë është rritur fondi i saj librar. Është shtuar edhe shkëmbimi i botimeve të Akademisë sonë me akademitë e vendeve të tjera. Presim që ky shkëmbim të jetë edhe më i madh gjatë vitit 2006.

Konsiderojmë se punonjësit e këtij Shërbimi edhe gjatë vitit 2005, me sukses i kanë kryer punët administrative, profesionale, teknike dhe punët e tjera, për nevojat e Akademisë.

**PROGRAMET E PUNËS TË SEKSIONEVE TË
ASHAK PËR VITIN 2006**

SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PROJEKTE

1. **Enciklopedia shqiptare** – projekt afatgjatë;
2. **Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe** (Bashkë me ASH të Shqipërisë);
3. **Konferencë shkencore për terminologjinë e gjuhës shqipe** (Bashkë me ASH të Shqipërisë);
4. **Sesion shkencor për letërsinë shqipe.**

BOTIME

1. Mikloshiç/Nahtingal, *STUDIME ALBANOLOGJIKE* (përkthim nga gjermanishtja);
2. Rexhep Ismajli, *STUDIME PËR GJUHËN SHQIPE*;
3. Martin Camaj, *FJALËNDËRTIMI NË GJUHËN SHQIPE* (Habilitationi- përkthim nga gjermanishtja);
4. *GJASHTË POETË TË SGJL TË ASHAK*: (në gjashtë vëllime të vogla, të përfshira në një kuti kompleti, paraqitet poezia e gjashtë anëtarëve të SGJL të ASHAK – Esad Mekuli, Enver Gjerqeku, Besim Bokshi, Ali Podrimja, Sabri Hamiti dhe Eqrem Basha);
5. Anton Pashku, *NJË VEPËR E ZGJEDHUR LETRARE*;
6. Henrik Hamp, *STUDIME PËR GJUHËN SHQIPE*;
7. Christian Gut, *PASHKO VASA* (monografi);
8. REVISTA ‘*STUDIME*’ 13;
9. W. Fiedler, *NDËRTIMI I SHUMËSIT NË GJUHËN SHQIPE.*

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

I. Projekte:

1. Vazhdimi i punës në **Enciklopedinë shqiptare** (bashkë me ASHSH-në).
2. **Arkitektura popullore tradicionale shqiptare** (bashkë me ASHSH-në).

II. Botime:

1. E. Riza, *“Banesa qytetare kosovare”*;
2. Aleks Buda, *Përmbledhje punimesh të zgjedhura* (një vëllim).
3. Revista *“Studime”* 13;

III. Përvjetorë:

Shënimi i 150-vjetorit të lindjes së Z. Frojdit.

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTE (bashkë me ASHSH-në):

1. **Enciklopedia shqiptare** – projekt afatgjatë;
2. Hartimi i “**Fjalorit shpjegues të termave të botanikës**”;
3. **Monitorimi i radioaktivitetit në mjedis, për analizat e përcaktimit të izotopeve radioaktive në mostra mjedisore dhe teknologjike, etj.**

BOTIME:

1. Minir Dushi, “*Veprimtaria kërkimore-shkencore në “Trepça*”;
2. Latif Susuri, “*Fjalori shumëgjuhësor i emrave të bimëve agronomike dhe dendrologjike*”;
3. Revista “*Kërkime*” 14.

TRYEZË SHKENCORE: “Hululmtimi i virozave bimore”

SEKSIONI I ARTEVE

PROJEKTE (Bashkë me ASHSH-në):

1. **Enciklopedia shqiptare** – projekt afatgjatë;
2. **Enciklopedia e artit shqiptar** – projekt afatgjatë.

BOTIME:

1. Rauf Dhomi: *Operë kamertale* (rreth 300 f.);
2. Engjëll Berisha: *Album për piano me veprat e akademikëve Rauf Dhomi e Zeqirja Ballata dhe kompozitorëve të tjerë të Kosovës.*

**PROCESVERBALET E KUVENDIT TË
AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE
TË KOSOVËS**

PROCESVERBAL

Nga mbledhja LVIII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 25 shkurt 2005, ora 11, në mjediset e Akademisë.

Marrin pjesë akademikët: Ali Podrimja, Besim Bokshi, Ekrem Murtezai, Enver Gjerqeku, Eqrem Basha, Esat Stavileci, Feriz Krasniqi, Hivzi Islami, Idriz Ajeti, Jashar Rexhepagiq, Mark Krasniqi, Minir Dushi, Muharrem Berisha, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli dhe anëtarët korrespondentë: Engjëll Berisha, Mehmet Kraja, Latif Susuri, Pajazit Nushi, Sabri Hamiti dhe Tahir Emra. Mori pjesë edhe akademik Zeqirja Ballata, i cili nuk jeton dhe nuk punon në Kosovë.

Gjithashtu, në mbledhje mori pjesë edhe mr. Zija Bylykbashi, sekretar i Akademisë.

Mbledhjen e kryesoi Rexhep Ismajli, kryetar i Akademisë.
Kuvendi miratoi këtë

R e n d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LVII të Kuvendit të Akademisë;
2. Shqyrtimi i Raportit të punës së ASHAK-ut për vitin 2004;
3. Shqyrtimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2004;
4. Shqyrtimi i Programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2005;
5. Shqyrtimi i Vendimit për themelimin e Qendrës Leksikografike-Enciklopedike të ASHAK-ut dhe i Rregullores së punës së Qendrës Leksikografike-Enciklopedike të ASHAK-ut;
6. Çështje vijuese.

Ad-1.-

Lidhur me procesverbalin diskutuan: Latif Susuri, Zeqirja Ballata, Engjëll Berisha, Hivzi Islami, Rexhep Ismajli, Zija Bylykbashi, Rauf Dhomi, Feriz Krasniqi, Jashar Rexhepagiq, Sabri Hamiti, Mark Krasniqi.

Disa nga diskutuesit folën për Vendimin e mbledhjes së kaluar të Kuvendit për mospërfshirjen në kuorumin e Kuvendit të Akademisë të anëtarëve të cilët, për shkak të sëmurjes së gjatë ose për ndonjë arsye tjetër, më shumë se një vit, nuk kanë marrë pjesë në punën e Akademisë, sidomos për mospërfshirjen e Zeqirja Ballatës. Për këtë çështje u dhanë shpjegime të mbështetura në Statutin e Akademisë dhe u konstatua se Vendimi për mospërfshirjen në kuorumin e Kuvendit të Akademisë edhe të Zeqirja Ballatës është plotësisht i mbështetur në Statutin e ASHAK-ut.

Procesverbali i mbledhjes LVII u miratua pa vërejtje, me rekomandimin që të korrigjohen disa gabime gjuhësore.

Ad-2.-

Në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kryetari i Akademisë bëri vlerësimin e punës së Akademisë për vitin e kaluar dhe me atë rast tha:

“Më lejoni që në hapje të kësaj mbledhjeje vjetore të Kuvendit të ASHAK të konstatoj se në vitin 2004 ASHAK në përgjithësi e ka vazhduar rrjedhën e përgjithshme të rritjes së punës dhe të aktiviteteve të saj të viteve të fundit drejt stabilizimit të rrjedhave themelore materiale dhe zgjerimit të mëtejshëm institucional të veprimtarisë.

1. Punën themelore ASHAK e ka zhvilluar në suaza të programeve të punës të seksioneve, të Kryesisë dhe të Kuvendit, por ka pasur dhe raste kur ka lindur nevoja për zgjerimin e kësaj veprimtarie me programe të reja të punës së seksioneve apo të Kryesisë. Në tërësi, viti 2004 mund të konsiderohet vit i suksesshëm i punës.

Në vitin 2004, ASHAK ka arritur të botojë veprat e anëtarëve të saj Bokshi, Hamiti, Nushi, Berisha, Zajmi, ta përfundojë serinë e veprave të Rizës, të botojë materialet e kolokiumit “Kosova sot dhe statusi i saj i ardhshëm”, të botojë veprat e Cimochofsk-it etj., sipas programeve të punës, dhe ta përgatisë e botojë veprën për Buzukun të anëtarit të jashtëm W. Fiedler. Gjatë kësaj kohe janë përgatitur edhe disa botime, që për arsye kryesisht teknike kanë mbetur për vitin vijues.

Mund të konstatohet qysh tash se sivjet ka ngecje në ritmin e botimit të revistës “*Studime*”, por janë marrë të gjitha masat që të arrihet ritmi i nevojshëm.

Gjatë këtij viti në ASHAK apo me (bashkë) organizim të ASHAK janë zhvilluar veprimtari të ndryshme shkencore: tryeza për S. Frashrin, Konferenca shkencore për leksikografinë, kolokuiumi “Kosova sot dhe statusi i saj i ardhshëm”, shënimi i 200-vjetorit të Kantit, përrurimi i veprës së Bokshit në Tiranë, të Pedersenit e Cimochofsk-it në Prishtinë, ekspozita e artistëve anëtarë të ASHAK, etj.

Në fushën e arteve, një pjesë e programeve, që kanë të bëjnë me ekzekutimin e veprave, ka mbetur pa u realizuar për shkaqe financiare.

2. Në veprimtarinë e bashkëpunimit ndërkombëtar ASHAK ka bërë hapa të rëndësishëm sa i përket integritit të saj në rrjetet ndërkombëtare akademike; është bërë anëtare me të drejta të barabarta e ALLEA-s – Federatës së Akademive Nacionale të Evropës, ka vazhduar punën në kuadër të Unionit të Akademive Nacionale të Evropës Juglindore me veprimtari të konkretizuar për herë të parë, është bërë bartëse e veprimtarisë së Komitetit Nacional të Kosovës për Studimet e EJL, ka vazhduar punën në Rrjetin Ndërkombëtar për të Drejtat e Shkencëtarëve, etj.

Gjatë këtij viti janë shënuar dhe suksese në raportet me akademitë e veçanta: me ASHSH-në u realizua Protokollin i kaluar i bashkëpunimit dhe para dy ditësh u nënshkrua Protokollin i ri dyvjeçar me program të gjerë pune. Dua të konstatoj se në bashkëpunimin konkret me ASHSH-në Protokollin ishte tejkaluar në disa pika, por kishin mbetur pa u realizuar disa pika të Protokollit, për të cilat bartës të veprimtarisë ishin instanca jashtë ASHAK.

Me Akademinë Sllovene praktikisht kemi bërë një protokoll të vogël bashkëpunimi, që është në realizim e sipër. Kemi marrë kontakte për intensifikimin e bashkëpunimit me akademi të tjera.

Suksese të veçanta mund të konsiderohen: themelimi i Këshillit Ndërkombëtar për Gjuhën Shqipe, themelimi eventual i Qendrës Leksikografike-Enciklopedike, etj.

3. Aspekti ligjor i ASHAK është vënë në linjë përditësimi të plotë: kemi Ligjin për ASHAK dhe jemi në procedurë e sipër për harmonizimin e Statutit dhe të rregulloreve të punës me Ligjin e ri.

Tani ASHAK do të jetë zë i veçantë në Buxhetin e Kosovës. Shpresojmë se buxheti për këtë vit do të jetë më i favorshëm.

Gjatë vitit të kaluar kemi pasur dhe vështirësi financiare: në dy muajt e fundit kemi punuar veresi.

Është i dukshëm përparimi në disa aspekte: janë konsoliduar shpërblimet e anëtarëve, pagesat e honorarëve dhe të punëve të tjera, por ende nuk është zgjidhur pagesa e punës së Kryesisë së ASHAK.

4. Sa i përket zgjidhjes së çështjes së mjediseve të punës, jemi në këtë gjendje: është siguruar hapësira, është shënuar madje momenti solemn i nisjes së ndërtimit, por kanë mbetur pa u zgjidhur disa probleme: largimi i banuesve të përkohshëm në objektet ekzistuese, ndryshimet në Projekt, etj. Për sivjet është paraparë dhe një shumë të hollash për punë.

5. Është bërë programi i ri i punës për vitin 2005 me buxhet të rritur dhe me veprimtari të ndryshme.

Këto ditë e kemi përfunduar punën për hapjen e faqes së ASHAK në Internet, fillimisht si provë, prandaj luten të gjithë të shikojnë dhe t'i japin vërejtjet.

6. Vitin që lamë pas i patëm zgjedhjet për anëtarë të rinj, rezultatin e të cilave e dimë të gjithë. Anëtarëve të rinj u uroj mirëseardhjen dhe punë të mbarë me ne. Gjithë duke theksuar me kënaqësi faktin se zgjedhjet janë zhvilluar tërësisht në pajtim me rregullat e ASHAK dhe Ligjin, dua të shpreh edhe një herë keqardhjen që nuk arritëm të zgjidhnim më shumë anëtarë të rinj dhe nuk pati avancime që mund të dëshironim”.

Pastaj u hap diskutimi, në të cilin morën pjesë: Sabri Hamiti, Engjëll Berisha, Zeqirja Ballata, Latif Susuri, Rexhep Ferri, Tahir Emra, Idriz Ajeti, Ali Podrimja. Ndër të tjera, u kërkua që në të ardhmen të bëhen përpjekje që raportet e seksioneve të shkruhen me një metodologji të përafërt.

Kuvendi miratoi Raportin e punës së ASHAK-ut për vitin 2004, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Ad-3.-

Kuvendi i Akademisë miratoi Raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2004, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Ad-4.-

Për Programin e punës së ASHAK-ut diskutuan: Sabri Hamiti, Enver Gjerqeku, Zeqirja Ballata, Rexhep Ismajli, Tahir Emra, Rexhep Ferri, Rauf Dhomi.

Programi i punës i ASHAK-ut për vitin 2005 u miratua nga Kuvendi me një pikë shtesë: **Konferencë shkencore me rastin e 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut.** Konferenca do të organizohet në bashkëpunim me Institutin e Historisë të Kosovës. Programi është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Ad-5.-

Në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit ë ditës, kryetari i Akademisë foli për nevojën e themelimit të një qendre leksikografike-enciklopedike pranë Akademisë sonë. Diskutuan edhe: Ekrem Murtezai, Jashar Rexhepagiq, Rexhep Ferri, Feriz Krasniqi, Sabri Hamiti, Enver Gjerqeku, Mark Krasniqi, Hivzi Islami.

Kuvendi i Akademisë me shumicë votash e miratoi këtë

V E N D I M

**PËR THEMELIMIN E QENDRËS LEKSIKOGRAFIKE-
ENCIKLOPEDIKE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE
TË ARTEVE TË KOSOVËS**

- Themelohet Qendra Leksikografike – Enciklopedike e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (në vazhdim: Qendra).
- Qendra është njësi shkencore e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.
- Kuvendi i Akademisë nxjerr rregullore të veçantë me të cilën përcaktohen detyrat e Qendrës.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Akademisë.

Kuvendi, gjithashtu me shumicë votash, vendosi që miratimi i Rregullores së punës së Qendrës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit. Njëherësh u ngrit Grupi për rishqyrtimin e

Projektregullores me këtë përbërje: Besim Bokshi, Hivzi Islami, Esat Stavileci, Pajazit Nushi dhe Zija Bylykbashi.

Ad-6.-

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës, Zeqirja Ballata rishtroi kërkesën e tij, dërguar më herët Kryetarit dhe Kryesisë së Akademisë, për t'u trajtuar sikurse edhe anëtarët e tjerë që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë(duke përfshirë këtu edhe pagesën e shpërblimit mujor të anëtarit të Akademisë), pasi që, sipas tij, ai shpesh vjen në Akademi dhe është i pranishëm në jetën kulturore të Kosovës. Kuvendi u informua për përgjigjen që i ka dhënë Ballatës Kryesia e Akademisë. Diskutuan: Rexhep Ismajli, Esat Stavileci, Besim Bokshi, Jashar Rexhepagiq, Zija Bylykbashi. U rikonstatua se kërkesa e Ballatës ka marrë përgjigje nga Kryesia e Akademisë, të mbështetur në Statutin e ASHAK-ut, të cilën e miratoi Kuvendi i Akademisë.

Mbledhja e Kuvendit u mbyll në orën 14⁰⁰.

Procesmbajtës

Kryetari i Akademisë

Mr. Zija Bylykbashi, d.v.

Akademik Rexhep Ismajli, d.v.

PROCESVERBAL

Nga mbledhja LIX e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 29 qershor 2005, ora 10⁰⁰, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Besim Bokshi, Enver Gjerqeku, Eqrem Basha, Esat Stavileci, Feriz Krasniqi, Hivzi Islami, Idriz Ajeti, Jashar Rexhepagiq, Mark Krasniqi, Minir Dushi, Muharrem Berisha, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli dhe anëtarët korrespondentë: Mehmet Kraja, Latif Susuri, Pajazit Nushi, Sabri Hamiti dhe Tahir Emra.

Merr pjesë edhe mr. Zija Bylykbashi, sekretar i Akademisë.

Mbledhjen e kryesoi Rexhep Ismajli, kryetar.

Në fillim të mbledhjes kryetari Ismajli e informoi Kuvendin për nënshkrimin në Londër të Memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunim midis Akademisë sonë dhe Akademisë Britanike.

Kuvendi miratoi këtë

R e n d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LVIII të Kuvendit të Akademisë;
2. Shqyrtimi i Programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2006;
3. Shqyrtimi i Projektstatutit të ASHAK-ut i harmonizuar me dispozitat e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;
4. Shqyrtimi i Rregullores së punës së Qendrës Leksikografike-Enciklopedike të ASHAK-ut.

Ad. 1.-

Procesverbali i mbledhjes LVIII të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Propozimi i Programit të punës së Akademisë për vitin 2006 u shqyrtua sipas radhës së seksioneve të Akademisë.

Në Kuvend u paraqit vërejtja e Kryesisë së Akademisë, si në vijim:

Pikat 4, 5 e 6 të Programit të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, ashtu si janë propozuar, nuk mund të realizohen pasi që nuk kanë mbështetje në Rregulloren mbi veprimtarinë botuese të ASHAK-ut.

Për Programin e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë diskutuan: H. Islami, N. Daci, E. Basha, J. Rexhepagiq, R. Ismajli, S. Hamiti, E. Gjerqeku, F. Krasniqi, Z. Bylykbashi, R. Ferri.

Ndër vërejtjet e diskutuesve janë edhe këto:

Programi i SGJL është i predimensionuar, mund të botohen vetëm botime kritike letrare e artistike (Rregullorja), të futen në Program ato pika që realisht mund të realizohen, etj.

Pas diskutimeve, Kuvendi miratoi Programin e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë për vitin 2006 me këto korrigjime:

1. Pika 5 e Programit (Projekte) hiqet,
2. Pikat 6 e 9 të Programit (Botime) hiqen.

U miratuan pa ndryshime Programi i Seksionit të Shkencave Shoqërore, i Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe i Seksionit të Arteve.

Ad. 3.-

Kuvendi miratoi njëzëri. Statutin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Ad.4.-

Kuvendi, gjithashtu pa asnjë votë kundër, miratoi Rregulloren e punës së Qendrës Leksikografike-Enciklopedike të ASHAK-ut.

Mbledhja u mbyll në orën 11⁴⁵.

Procesmbajtës

Kryetari i Akademisë

Mr. Zija Bylykbashi, d.v.

Akademik Rexhep Ismajli, d.v.

PROCESVERBAL

Nga mbledhja LX e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 8 nëntor 2005, ora 10⁰⁰, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Ali Podrimja, Besim Bokshi, Ekrem Murtezai, Enver Gjerqeku, Eqrem Basha, Esat Stavileci, Feriz Krasniqi, Hivzi Islami, Idriz Ajeti, Jashar Rexhepagiq, Mark Krasniqi, Muharrem Berisha, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli dhe anëtarët korrespondentë: Engjëll Berisha, Mehmet Kraja, Latif Susuri, Pajazit Nushi dhe Tahir Emra.

Merr pjesë edhe Mr. Zija Bylykbashi, sekretar i Akademisë.

Mbledhjen e kryesoi Rexhep Ismajli, kryetar.

Kuvendi miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LIX të Kuvendit të Akademisë;
2. Emërimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë;
3. Zgjedhja e Kryesisë së Akademisë;
4. Çështje vijuese.

Ad. 1.-

Procesverbali i mbledhjes LIX të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Kuvendi emëroi Komisionin e zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë me këtë përbërje:

Esat Stavileci, kryetar

Ali Aliu, anëtar

Rexhep Ferri, anëtar

Feriz Krasniqi, anëtar

Zija Bylykbashi, anëtar.

Ad. 3.-

Komisioni i zgjedhjeve i përgatiti dhe i shpërndau fletëvotimet për zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe të sekretarit të përgjithshëm të Akademisë dhe fletëvotimet për verifikimin e zgjedhjeve të sekretarëve të seksioneve të Akademisë.

Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i zgjedhjeve u tërhoq, i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këto rezultate:

I. Për zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe të sekretarit të përgjithshëm të Akademisë kanë votuar 22 anëtarë të ASHAK-ut, janë gjetur 20 fletëvotime të vlefshme dhe 2 fletëvotime të pavlefshme.

1. **Për kryetar të ASHAK-ut Rexhep Ismajli ka marrë 19 vota.**
2. **Për nënkryetar të ASHAK-ut Besim Bokshi ka marrë 20 vota.**
3. **Për sekretar të përgjithshëm të ASHAK-ut Hivzi Islami ka marrë 20 vota.**

Në bazë të votave të fituara rezulton se:

1. Rexhep Ismajli është zgjedhur kryetar i ASHAK-ut për mandatin e ardhshëm trevjeçar;
2. Besim Bokshi është zgjedhur nënkryetar i ASHAK-ut për mandatin e ardhshëm trevjeçar;
3. Hivzi Islami është zgjedhur sekretar i përgjithshëm i ASHAK-ut për mandatin e ardhshëm trevjeçar.

II. Për verifikimin e zgjedhjes së sekretarëve të seksioneve të Akademisë kanë votuar 22 anëtarë të ASHAK-ut, janë gjetur 21 fletëvotime të vlefshme dhe 1 fletëvotim i pavlefshëm.

1. **Për sekretar të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë Eqrem Basha ka marrë 19 vota;**
2. **Për sekretar të Seksionit të Shkencave Shoqërore Ekrem Murtezai ka marrë 17 vota;**
3. **Për sekretar të Seksionit të Shkencave të Natyrës Muharrem Berisha ka marrë 20 vota;**
4. **Për sekretar të Seksionit të Arteve Rauf Dhomi ka fituar 18 vota.**

Në bazë të numrit të votave të fituara rezulton se:

1. Është konfirmuar zgjedhja e **Eqrem Bashës** sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë;
2. Është konfirmuar zgjedhja e **Ekrem Murtezait** sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore;
3. Është konfirmuar zgjedhja e **Muharrem Berishës** sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës;
4. Është konfirmuar zgjedhja e **Rauf Dhomit** sekretar i Seksionit të Arteve.

Në emër të Komisionit të zgjedhjeve, pas komunikimit të rezultateve të votimit, Esat Stavileci i uroi Kryesisë së zgjedhur suksese në punë.

Kryetari i Akademisë shprehu fjalë falënderimi, në emër të tij dhe të anëtarëve të tjerë të zgjedhur të Kryesisë, për besimin e dhënë dhe premtoi se do të angazhohet për të bërë gjithçka që është e mundur për t'i realizuar detyrat që dalin nga planet dhe programet e punës së Akademisë. Ai u bëri thirrje të gjithë anëtarëve të Akademisë që t'i paraqesin projektet e tyre dhe iu premtoi përkrahjen e tij dhe të Kryesisë.

Ad.4.-

U vendos që pas mbledhjes së Kuvendit të shtrohet një drekë e përbashkët për të gjithë anëtarët dhe punonjësit e Akademisë.

Mbledhja u mbyll në orën 11⁰⁰.

Procesmbajtës

Kryetari i Akademisë

Mr. Zija Bylykbashi, d.v.

Akademik Rexhep Ismajli, d.v.

**VENDIMI DHE RREGULLORJA
PËR QENDRËN LEKSIKOGRAFIKE-
ENCIKLOPEDIKE**

Në bazë të neneve 7 e 12/b të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe neneve 14 dhe 33 të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Kuvendi i Akademisë, në mbledhjen e dt.25 shkurt 2005, miratoi këtë

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E QENDRËS LEKSIKOGRAFIKE –
ENCIKLOPEDIKE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE
TË ARTEVE TË KOSOVËS

- Themelohet Qendra Leksikografike – Enciklopedike e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (në vazhdim: Qendra).
- Qendra është njësi shkencore e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.
- Kuvendi i Akademisë nxjerr rregullore të veçantë me të cilën përcaktohen detyrat e Qendrës.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Akademisë.

Kryetari i Akademisë

Akademik Rexhep Ismajli, d.v.

Në bazë të neneve 7, 9 (pikat 6 e 7) dhe 12/ b të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe neneve 14 dhe 33 të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Kuvendi i Akademisë, në mbledhje e dt. 29 qershor 2005, miratoi këtë

R R E G U L L O R E
TË PUNËS SË QENDRËS LEKSIKOGRAFIKE –
ENCIKLOPEDIKE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE
TË ARTEVE TË KOSOVËS

Neni 1

Qendra Leksikografike – Enciklopedike e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (në vazhdim: Qendra) është njësi shkencore e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (në vazhdim: Akademia).

Neni 2

Akademia e përfaqëson Qendrën në të gjitha çështjet e punës së saj.

Neni 3

Qendra përbëhet nga dy degë:

- Dega e leksikografisë dhe
- Dega e enciklopedisë.

Neni 4

Qendra ka këto detyra:

I. Detyrat teorike në fushë të leksikut:

1. Studimi i leksikut dhe i frazeologjisë së gjuhës shqipe;
2. Hulumtimi i prejardhjes kuptimore dhe i evaluimit semantik të fjalëve dhe të termave të gjuhës shqipe;
3. Vlerësimi i të arriturave në leksikografi, në leksikologji e në frazeografi të gjuhës shqipe;
4. Identifikimi i tendencave të zhvillimit të leksikut të shqipes;
5. Trajtimi i çështjeve të pasurimit të gjuhës standarde me shprehje e fjalëformime nga gurra e të folurit popullor;

6. Trajtimi i depërtimit të fjalëve të huaja;
7. Planifikimi i hulumtimeve të zhvillimit të leksikut të shqipes.

II. Detyrat praktike në fushë të leksikut:

- Evidentimi i fjalorëve shpjegues, terminologjikë dhe enciklopedikë;
- Regjistrimi i vlerësimeve për fjalorët e botuar;
- Përpilimi i programit të botimit të fjalorëve;
- Botimi i fjalorëve;
- Përcjellja e vlerësimeve të fjalorëve të botuar;
- Bashkëpunimi me institucionet e studimeve leksikore të shqipes;
- Përpilimi i kartotekës të leksikut të gjuhës shqipe.

III. Detyrat teorike dhe praktike në fushë të enciklopedisë:

- Studimi i zhvillimit të enciklopedistikës bashkëkohore;
- Studimi i zhvillimit të mendimit enciklopedik shqiptar;
- Marrëveshja e bashkëpunimit për konceptimin dhe për realizimin e projektit “Enciklopedia shqiptare”;
- Fillimi i punës për hartimin e fjalësit të Enciklopedisë shqiptare;
- Botimi i Enciklopedisë shqiptare dhe i veprave enciklopedike të veçanta;
- Vështrimi kritik i prezantimit të shqiptarëve dhe të historisë së tyre në enciklopeditë e huaja.

Neni 5

Punonjësit shkencorë e profesionalë të Qendrës zgjidhen me konkurs.

Kushtet e konkursit i përcakton Kryesia e Akademisë.

Zgjedhjen e punonjësve shkencorë e profesionalë të Qendrës e bën Kryesia e Akademisë, në bazë të propozimit të komisionit të konkursit.

Kryesia e Akademisë vendos edhe për çështje të tjera nga marrëdhënia e punës për punonjësit shkencorë dhe profesionalë të Qendrës.

Për çdo punë tjetër lidhur me punonjësit nga paragrafi i mësipërm zbatohen dispozitat e përgjithshme, që kanë të bëjnë me punonjësit shkencorë e profesionalë.

Neni 6

Qendra e ka drejtorin. Drejtori zgjidhet me konkurs.

Drejtori duhet të jetë doktor i shkencave filologjike dhe ta njohë së paku një gjuhë botërore.

Zgjedhjen e drejtorit e bën Kuvendi i Akademisë, në bazë të propozimit të komisionit përkatës, të cilin e zgjedh Kryesia e Akademisë.

Për punën e Qendrës drejtori i përgjigjet Kuvendit të Akademisë.

Neni 7

Degën e Qendrës e drejton Udhëheqësi i Degës. Udhëheqësi i Degës zgjidhet me konkurs.

Udhëheqës i Degës së Leksikografisë mund të zgjidhet personi që ka gradën e doktorit të shkencave filologjike, në fushën e gjuhësisë.

Zgjedhjen e Udhëheqësit të Degës së Leksikografisë e bën Kryesia e Akademisë, në bazë të propozimit të komisionit përkatës të zgjedhur nga Kryesia e Akademisë.

Udhëheqësi i Degës së Enciklopedisë zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Akademisë.

Neni 8

Qendra ka Këshillin Shkencor, i cili përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë.

Anëtarët e Këshillit Shkencor i zgjedh Kuvendi i Akademisë me propozim të Kryesisë së Akademisë.

Drejtori i Qendrës është anëtar i Këshillit Shkencor.

Neni 9

Këshilli Shkencor ka kryetarin e tij.

Kryetari i Këshillit zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Këshillit.

Drejtori i Qendrës nuk mund të jetë kryetar i Këshillit Shkencor.

Neni 10

Mandati i anëtarëve të Këshillit Shkencor zgjat katër vjet.

Neni 11

Këshilli Shkencor mblidhet sipas nevojës.
Mbledhjet i thërret dhe i kryeson kryetari i Këshillit.

Neni 12

Këshilli Shkencor ka këto kompetenca:

- miraton programin e punës të Qendrës;
- miraton raportin vjetor të punës të Qendrës;
- miraton planin financiar dhe raportin vjetor financiar të Qendrës;
- shqyrton dhe vlerëson detyrat teorike dhe praktike të parapara me nenin 4 të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Punët administrative, profesionale, financiare dhe teknike të Qendrës, i kryen Shërbimi administrativ, profesional e teknik i Akademisë.

Neni 14

Qendra financohet nga buxheti i Akademisë dhe nga format e tjera të parapara me Statutin e Akademisë, nga mjetet e veçanta të parapara me plan të posaçëm financiar.

Të ardhurat që i krijon Qendra janë në dispozicion të Akademisë.

Neni 15

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Akademisë.

Kryetari i Akademisë

Akademik Rexhep Ismajli, d.v.

KRONIKË – 2005

(Aktivitete shkencore, ekspozita, vizita, përvjetorë, ligjërata, përrurime...)

MYFTIU I KOSOVËS VIZITON ASHAK-un

Myftiu i Kosovës, z. Naim Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij: z. Ahmet Sadria, anëtar i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, z. Qemajl Morina, prodekan i Fakultetit të Besimit Islam, dhe z. Ejup Ramadani, shef i Kabinetit të Myftiut të Kosovës, vizitoi Akademinë më 10 janar 2005.

Myftiu dhe shoqëruesit e tij u pritën nga akademik Rexhep Ismajli, kryetar, akademik Hivzi Islami, sekretar i përgjithshëm, akademik Eqrem Basha, anëtar i Kryesisë së ASHAK-ut, dhe mr. Zija Bylykbashi, sekretar i Akademisë.

Kryetari Ismajli iu uroi mirëseardhjen mysafirëve dhe i informoi ata për historikun, strukturën organizative, përbërjen, punën e deritanishme dhe për planet e Akademisë në të ardhmen.

Myftiu Tërnavë shprehu fjalë falënderimi për pritjen dhe për informacionin që mori. Ai, gjithashtu, shprehu kënaqësinë e tij për vizitën që ai dhe bashkëpunëtorët e tij po i bëjnë Akademisë, institucionit më të lartë të dijes në Kosovë, dhe deklaroi se Akademia është zgjedhur prej tyre, jo rastësisht, të jetë institucioni i parë që e vizitonte në këtë vit.

U shpreh gatishmëria për bashkëpunim për problemet me interes të ndërsjellë, si p.sh. në fushën e terminologjisë fetare, në shënimin e përvjetorëve, që bashkërisht çmohen të rëndësishëm etj. U fol edhe për mundësinë e bashkëpunimit të Akademisë sonë me akademitë e vendeve të Lindjes, sidomos me atë të Egjiptit, të Turqisë e ndonjë tjetër. Myftiu Tërnavë me këtë rast u dhuroi mikpritësve nga një libër të Thomas W. Arnold-it, *“Historia e përhapjes së Islamit”*.

NËNSHKRUHET NË TIRANË PROTOKOLLI PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS ASHAK-ut DHE ASHSH-së

Delegacioni i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (akad. Rexhep Ismajli, kryetar, akad. Besim Bokshi, nënkryetar, akad. Hivzi Islami, sekretar i përgjithshëm, dhe mr. Zija Bylykbashi, sekretar i Akademisë) bëri një vizitë pune në Tiranë (21-23/02/05). Qëllimi i kësaj vizite ishte nënshkrimi i Protokollit për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor e Artistik ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, për periudhën e ardhshme dyvjeçare (shkurt 2005-shkurt 2007).

Delegacioni u prit dhe u shoqërua nga kryetari i ASHSH, akademik Ylli Popa, dhe nga personalitetet më të larta të kësaj Akademie.

Bisedimet dhe pritja u zhvilluan në frymë vëllazërore, në mirëkuptim të plotë dhe me dëshirën e mirë për përmbushjen e synimeve të përbashkëta, të shprehura në veprimtaritë e parashtruara në Protokoll.

Protokollu u nënshkrua nga akademik Hivzi Islami, për palën kosovare, dhe nga akademik Eduard Sulstarova, për palën shqiptare.

Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë: delegacioni i ASHAK-ut, Kryesia e ASHSH-së, drejtues të institucioneve dhe të strukturave të rëndësishme të ASHSH-së dhe përfaqësues të medieve.

Delegacioni i ASHAK-ut, më 22 shkurt, mori pjesë edhe në përrurimin e *Fjalorit sinonimik të gjuhës shqipe*, i cili u bë në sallën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ndërkaq të nesërmen, më 23 shkurt, delegacioni u prit edhe nga Avokati i Popullit i Shqipërisë, zoti Ermir Dobjani.

PËRURORHET VEPRA E AKADEMIK GAZMEND ZAJMIT

Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 15 mars 2005, ora 11.00, u organizua përrurimi i *Veprës* (në katër vëllime) së akademik Gazmend Zajmit.

Për jetën dhe veprën e Zajmit folën akademik Ekrem Murtezai, akademik Rexhep Ismajli dhe akademik Esat Stavileci.

Në përrurim morën pjesë, përveç anëtarëve të Akademisë, edhe pjesëtarë të familjes Zajmi, dashamirës të akademik Zajmit dhe të veprës së tij dhe përfaqësues të medieeve.

TRYEZË SHKENCORE ME RASTIN E 450-VJETORIT TË BOTIMIT TË “MESHARIT” TË GJON BUZUKUT

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës organizoi Tryezën shkencore: “MESHARI i Gjon Buzukut- në 450-vjetorin e botimit”, e cila u mbajt më 17 mars 2005, në mjediset e Akademisë.

Në Tryezë u lexuan këto kumtesa:

1. Rexhep Ismajli: “*Meshari*” dhe studimet buzukiane.
2. Idriz Ajeti: Gjuha e “*Mesharit*” të Buzukut në përqsje me të folmen e Shestanit.
3. Wilfried Fiedler: Foljet e zgjedhimit të katërt në “*Mesharin*” e Buzukut.
4. Seit Mansaku: Disa veçori morfosintaksore të shqipes mesjetare në “*Mesharin*” e Gjon Buzukut.
5. Imri Badallaj: Rreth kuantitetit të vokaleve në “*Mesharin*” e Gjon Buzukut.
6. Kolec Topalli: Veçori të shqipes së shekullit XVI përmes veprës së Buzukut.
7. Bardhyl Demiraj: Receptsi i “*Mesharit*” të Buzukut në arealin kulturor italo-arbëresh.
8. Ragip Mulaku: Disa fenomene fonetike të “*Mesharit*” të Buzukut në përqsje me të shkrimtarëve të tjerë të vjetër.
9. Besim Bokshi: Vështrim krahasues i tipit të sistemit rasor të “*Mesharit*” të Buzukut me tipat e tjerë të sistemit rasor të shqipes.

Punimet e Tryezës u ndoqën nga anëtarët e Akademisë, nga studiues dhe dashamirës të veprës së Buzukut dhe nga përfaqësues të medieeve. Tryeza u vlerësua e suksesshme.

TRYEZË SHKENCORE
“KOMUNIKIMET LETRARE NË BOTËN SHQIPTARE”

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, më 30 mars 2005, në mjediset e veta organizoi Tryezën shkencore: *Komunikimet Letrare në Botën Shqiptare*.

Në praninë e anëtarëve të Akademisë, të studiuesve të letërsisë dhe të përfaqësuesve të medieve, kumtesat e tyre i mbajtën studiues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia.

Fjalën e hapjes e mbajti Sabri Hamiti, i cili, njëherësh, e drejtoi seancën e parë të Tryezës. Seancën e dytë e drejtoi Ali Aliu.

U lexuan këto kumtesa:

Ali Aliu: **VLERA QË S’KOMUNIKOJNË**

Kristaq Jorgo: **KOMUNIKIMI DHE VETËDIJA E KOMUNIKIMIT**

Mehmet Kraja: **KONTRADIKTAT LETRARE SHQIPËRI - KOSOVË**

Nazmi Rrahmani: **BOTIMET, QARKULLIMI, PENGESAT...**

Ali Podrimja: **KOMUNIKIME NË SINKOPA**

Sabri Hamiti: **SHKRIMTARI DHE STUDIUSI KOSOVAR**

Agron Tufa: **SHUMËLLOJSHMËRIA DHE IDENTITETI I BOTËS LETRARE**

Kim Mehmeti: **PRINCIPATAT LETRARE SHQIPTARE**

Sadik Bejko: **SI PËRCILLESHIN NË TIRANË LIBRAT E POETËVE NGA PRISHTINA NË VITET ‘70**

Enver Gjerqeku: **KOMUNIKIMET TONA LETRARE – VLERA SHPIRTËRORE DHE INTELEKTUALE**

Ali Aliu mbajti fjalën përmbyllëse të Tryezës. Tryeza u vlerësua e suksesshme.

ASHAK-un E VIZITOI ZËVENDËSDREJTORI
I BIBLIOTEKËS SË ALEKSANDRISË

Zëvendësdrejtori i Bibliotekës së Aleksandrisë, zoti Taher Khalifa, më 13 prill 2005 vizitoi Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Ai u prit nga akademik Hivzi Islami, sekretar i

përgjithshëm, dhe akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

HAPET NË TIRANË EKSPOZITA RETROSPEKTIVE E TAHIR EMRËS

Në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë, në kuadër të bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, më 14 prill 2005, ora 19,00, u hap Ekspozita retrospektive e Tahir Emrës, anëtar korrespondent i ASHAK-ut. Në hapje morën pjesë artistë dhe njerëz të kulturës. Ishin të pranishëm edhe akademik Besim Bokshi, nënkryetar i ASHAK-ut, akademik Luan Omari, zëvendëskryetar i ASHSH-së, akademik Rauf Dhomi, sekretar i Seksionit të Arteve të ASHAK-ut, akademik Eduard Sulstarova, sekretar shkencor i ASHSH-së. Akademik Rexhep Ferri foli për veprën e Emrës dhe, në emër të të dy akademive tona, e shpalli të hapur Ekspozitën. Foli edhe z. Abaz Hado, drejtor i Galerisë, i cili e vlerësoi bashkëpunimin e ASHSH/ASHAK me Galerinë e Arteve të Tiranës.

Janë ekspozuar 55 piktura, të gjitha në teknikën vaj në pëlhurë, të përzgjedhura nga vetë autori. Ekspozita do të jetë e hapur deri më 30 prill 2005.

Mediet e Tiranës dhe të Prishtinës e shënuan dhe e vlerësuan Ekspozitën si ngjarje të rëndësishme në fushën e kulturës.

PËRFAQËSUESIT E ASHAK-ut NË MASHT

Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Rexhep Ismajli, i shoqëruar nga sekretari i Akademisë mr. Zija Bylykbashi, më 6 qershor 2005, vizitoi Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë. Ata u pritën nga ministri, z. Agim Veliu, dhe nga bashkëpunëtorët e tij: Jusuf Zeneli, sekretar i përhershëm, Xhavit Rexha, drejtues i Departamentit të Arsimit, Rrahim Bublaku, drejtor i financave, dhe Fadile Dyla, udhëheqëse e Departamentit të Infrastrukturës. U bisedua për çështjet që kanë të bëjnë me ngritjen e godinës së re të Akademisë. Kryetari i Akademisë,

pas konstatimit se Akademisë nuk i është dorëzuar asnjë njoftim me shkrim për rrjedhën e deritanishme të punëve, kërkoi nga ministri Veliu që Akademisë t'i parashtrahet një raport me shkrim, i cili do të përfshinte pjesën përshtuese të punëve të kryera, pjesën arkitektonike dhe pjesën financiare, lidhur me godinën e re të Akademisë. Njëherësh u shtrua kërkesa që trualli i Akademisë të zgjerohet, të rritet lartësia e katit përdhes, të largohet godina sa më larg rrugës dhe hyrja në Akademi të jetë zgjidhje e veçantë arkitektonike, e denjë për një institucion çfarë është Akademia. Ministri Veliu premtoi se do të angazhohet për zgjidhjen e çështjeve kontestuese dhe për dërgimin e një raporti gjithëpërfshirës për të gjitha punët që i ka bërë Ministria për godinën e re të Akademisë.

KRYETARI ISMALJI NË MINISTRINË E EKONOMISË DHE TË FINANCAVE

Kryetari i Akademisë, akademik Rexhep Ismajli, bashkë me akademik Hivzi Islamin, sekretar i përgjithshëm, dhe mr. Zija Bylykbashin, sekretar i Akademisë, më 12 qershor 2005, u pritën nga z. Haki Shatri, ministër i Ekonomisë dhe i Financave në Qeverinë e Kosovës. Ata e informuan ministrin Shatri për problemet e shfaqura lidhur me ndërtimin e godinës së re të Akademisë dhe kërkuan prej tij të angazhohet për zgjidhjen e tyre. U kërkua, gjithashtu, zgjidhja e çështjes së shpërblimeve për anëtarët e Akademisë, që kryejnë funksione të caktuara në Akademi. Ministri Shatri premtoi angazhimin e tij për zgjidhjen e të dy këtyre çështjeve, si dhe të çështjeve të tjera, që i përkasin resorit të tij në funksion të krijimit të mundësive sa më të favorshme për veprimtarinë e Akademisë.

NË TAKIMIN BIENAL TË RRJETIT NDËRKOMBËTAR NDËRAKADEMIK PËR TË DREJTAT E NJERIUT MERR PJESË EDHE KRYETARI ISMAJLI

Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Rexhep Ismajli, e ka përfaqësuar Akademinë tonë në

Takimin Bienal të Rrjetit Ndërkombëtar Ndërkademik për të Drejtat e Njeriut, që u mbajt në Londër prej 17-22 mars 2005. Takimin e ka drejtuar prof. Torsten Wiesel, drejtues i deritashëm i Rrjetit, fitues i Çmimit Nobel, ndërsa mori pjesë edhe Peter Agre, gjithashtu nobelist, drejtues i ri i Rrjetit. Në Seksionin për Evropën, ku bëjmë pjesë edhe ne, pos çështjeve të tjera të fushës së të drejtave të njeriut me përqendrim në fushën e shkencave, përfaqësuesi ynë shtroi çështjen e pengesave që u dalin studiuesve, sidomos të rinj, nga Kosova në procesin e shkëmbimeve ndërkombëtare për arsye që janë jashtë organizimit shkencor, si çështja e vizave dhe e dokumentacionit, duke konstatuar se kjo mund të shpjerë drejt izolimit të mëtejshëm. Seksioni e veçoi këtë çështje si një prej problemeve të kësaj fushe dhe pastaj kjo hyri në përfundimet e përgjithshme.

Gjatë këtyre ditëve u mbajt edhe Simpoziumi për të Drejtat e Njeriut në Fushën e Shkencës, në të cilin ligjëruan ekspertë ndërkombëtarë dhe anëtarë të akademive të ndryshme. U prezantua edhe projekti izraelito-palestinez për hulumtime të përbashkëta shkencore.

NËNSHKRUHET NË LONDËR MEMORANDUMI I MIRËKËPTIMIT DHE BASHKËPUNIMIT MIDIS AKADEMISË BRITANIKE DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Në Londër, më 19 maj 2005, kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Rexhep Ismajli, dhe, në mungesë të Kryetarit, nënkryetari i Akademisë Britanike, profesor Nicholas Mann, nënshkruan Memorandumin e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit midis Akademisë Britanike dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Memorandumi mëton ta promovojë dhe zhvillojë bashkëpunimin shkencor dhe studimor në fushat e shkencave humane dhe shoqërore, sidomos:

- të mundësojë realizimin e projekteve dhe të konferencave shkencore me interes të ndërsjellë për hulumtuesit e të dy vendeve;

- të mundësojë vizita individuale studimore të ndërsjella për studiues, të cilët do të merren me hulumtime.

PËRFAQËSUESIT E ASHAK-ut NË AMSTERDAM TË HOLANDËS

Akademikët Hivzi Islami, sekretar i përgjithshëm, dhe Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, e përfaqësuan Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në tubimin shkencor me temën bosht: VLERAT E PËRBASHKËTA NË HAPËSIRËN KËRKIMORE EVROPIANE (shkencëtarë dhe studiues evropianë dhe përgjegjësitë e tyre) organizuar nga ALLEA, në bashkëpunim me Academia Europaea dhe Euro Science në Amsterdam, më 19 e 20 maj 2005.

Tubimi shtroi shumë probleme me të cilat ballafaqohen institucionet shkencore evropiane, me theks të veçantë në bashkëpunimin rreth projekteve me rëndësi për mbarë njerëzimin (biomedi, emigracioni, ambienti, etj.). U fol për çështjet e etikës shkencore dhe për rolin e akademikëve në këtë fushë, për përgjegjësinë e shkencëtarit ndaj shoqërisë dhe të shoqërisë ndaj hulumtimeve specifike shkencore, (klonimi, bio-etika, etj.). Ky tubim për përfaqësuesit e ASHAK-ut ishte, siç theksuan ata, i një rëndësie të veçantë për kontaktet që patën me anëtarë të shumë akademive evropiane (merrnin pjesë përfaqësuesit e Anglisë, Francës, Holandës, Zvicrës, Turqisë, Norvegjisë, Shqipërisë, Bullgarisë, Serbisë-Malit të Zi, Estonisë, Çekisë, Polonisë, Greqisë, etj.), si dhe përfaqësues të Komisionit Evropian, që ishte njëri nga mbështetësit e këtij aktiviteti. Me disa nga pjesëmarrësit, në kontakte të veçanta, u diskutuan çështje të bashkëpunimit të ASHAK-ut me akademitë e tyre, ndërsa me kryetarin e ALLEA-s, z. Pieter Drenth, si dhe me drejtorin e Qendrës “Shkenca dhe shoqëria” të Komisionit Evropian, z. Rainer Gerold, u bisedua për mundësinë e vizitës së tyre në Akademinë tonë dhe për mbajtjen e ligjëratave nga fushëveprimet e tyre.

Për përfaqësuesit e ASHAK-ut ky tubim shkencor pati efekte të shumanshme dhe solli përvoja dhe lidhje të reja, të domosdoshme për hapjen dhe njohjen tonë jashtë kufijve të Kosovës.

PËRURUHET VEPRAT NË KATËR VËLLIME E SELMAN RIZËS

Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 17 qershor 2005, u përurua vepra albanologjike në katër vëllime e gjuhëtarit, intelektualit dhe patriotit të shquar profesor Selman Riza (Gjakovë 1909-1988 Tiranë), botuar nga Akademia jonë.

Në praninë e anëtarëve të Akademisë sonë, të përfaqësuesve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të familjarëve të Selman Rizës, të punonjësve shkencorë të fushës së gjuhësisë, dashamirëve të figurës dhe të veprës së profesor Rizës dhe të medieeve, për jetën dhe veprën e S. Rizës folën: akademik Rexhep Ismajli, akademik Idriz Ajeti dhe akademik Besim Bokshi. Në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë foli akademik Fahrudin Hoxha, zëvendëskryetar. Të gjithë folësit vunë në pah kontributin e çmuar të prof. Rizës. Po në këtë ditë, prof. Selman Riza u dekorua me Medalje të Artë të Lidhjes së Prizrenit nga kryetari i Kosovës, z. Ibrahim Rugova.

NËNKRYETARI I AKADEMISË BRITANIKE VIZITON ASHAK-un

Profesor Nicholas Mann, nënkryetar e sekretar për marrëdhënie me jashtë të Akademisë Britanike dhe zëvendësrektor i Universitetit të Londrës, i shoqëruar nga znj. Jane Lyddon, përgjegjëse e Departamentit për Marrëdhënie me Jashtë në Akademinë Britanike, vizitoi Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 21-24 shtator 2005.

Në mjediset e Akademisë, në praninë e anëtarëve të Akademisë, të përfaqësuesve të instituteve shkencore e të kulturës të Kosovës dhe të medieeve, më 22 shtator 2005, ora 10, prof. Mann mbajti një ligjëratë për marrëdhëniet ndërakademike të Akademisë Britanike, për ndërtimin, funksionimin dhe për mënyrën e financimit të veprimtarive shkencore të saj. Pas ligjëratës, anëtarët e Akademisë i shtruan pyetje profesorit Mann, i cili me dëshirë u dha përgjigje.

Kjo është vizita e parë e ndonjë përfaqësuesi të Akademisë Britanike në Kosovë, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së mirëkuptimit për bashkëpunim midis dy akademive, të nënshkruar në Londër, më

19 maj 2005, nga akademik Rexhep Ismajli, kryetar i ASHAK-ut, dhe profesori Nicholas Mann, nënkryetar i Akademisë Britanike.

Gjatë qëndrimit të tij në Kosovë prof. Mann vizitoi edhe Institutin Albanologjik, Muzeun e Kosovës, Shpellën e Mermertë të Gadimes, qytetin antik Ulpiana, lokalitetin arkeologjik të Bardhoshit, Prizrenin dhe Gjakovën.

KOMANDANTI I KFOR-it VIZITON ASHAK-un

Gjenerali Guisepe Valotto, i shoqëruar nga z. Ismet Beqiri, kryetar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, dhe nga disa oficerë të KFOR-it, vizitoi Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 25 shtator 2005. Mysafirët u pritën nga akademik Rexhep Ismajli, kryetar, dhe bashkëpunëtorët e tij, akademik Besim Bokshi, nënkryetar, akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, dhe mr. Zija Bylykbashi, sekretar i Akademisë.

Kryetari Ismajli u foli mysafirëve për historikun e Akademisë, për veprimtarinë e deritanishme dhe për objektivat që synon t'i arrijë Akademia në të ardhmen. Foli edhe për marrëdhëniet ndërakademike të Akademisë sonë me akademitë e jashtme, duke theksuar me këtë rast edhe bashkëpunimin me Akademinë Kombëtare të Shkencave të Dyzetëve (Accademia Nazionale Delle Scienze Detta Dei XL) të Romës me të cilën Akademia jonë ka nënshkruar, më 14 gusht 2003, në Prishtinë, Marrëveshjen e bashkëpunimit shkencor. Ai njëherësh falënderoi komandantin Valotto për kontributin e KFOR-it në ruajtjen e paqes në Kosovë. E falënderoi edhe kryetarin Beqiri për angazhimin e tij në zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me ngritjen e godinës së re të Akademisë.

Gjenerali Valotto falënderoi kryetarin Ismajli dhe shprehu kënaqësinë e tij për pritjen dhe për informatat që i mori mbi punën e Akademisë.

Në fund të vizitës kryetari Ismajli i dhuroi Gjeneralit një kopje të librit "*Nëna e dashurisë*" (kushtuar Nënës Tereze) të autorit Lush Gjergji, botim i Akademisë sonë.

**PROFESOR DR. GUSTAV ADOLF LEHMANN,
NËNKRYETAR I AKADEMISË SË SHKENCAVE TË
GËTINGENIT, NË ASHAK**

Në kuadër të bashkëpunimit të ardhshëm me akademitë gjermane, i ftuar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave të Arteve të Kosovës, nënkryetari i Akademisë së Shkencave të Gëtingenit, njëherë nga më të vjetrat në Gjermani, profesor dr. Gustav Adolf Lehmann vizitoi Akademinë tonë (26-30 shtator 2005).

Profesori Lehmann njëherësh është edhe kryetar i Seksionit të Filologjisë-Historisë të kësaj Akademie, drejtor i Seminarit të Historisë së Lashtë në Universitetin e Gëtingenit, profesor i historisë së lashtë.

Në mjediset e Akademisë, prof. Lehmann pati takim me anëtarët e Kryesisë së Akademisë dhe pastaj mbajti një ligjëratë për akademitë e Gjermanisë, sidomos për strukturën organizative dhe funksionimin e Akademisë së Gëtingenit, si dhe për arritjet e tij shkencore në fushën e historisë së lashtë. Ligjëratat u ndoq nga anëtarët e Akademisë, nga punonjës shkencorë të institucioneve tona shkencore dhe nga përfaqësuesit e medieve.

Prof. Lehmann, gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, vizitoi Muzeun e Kosovës, Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare, Fakultetin e Filozofisë- Degën e Historisë, Fakultetin e Filologjisë - Degën e Gjermanishtes, qytetin antik Ulpiana, Prizrenin, Gjakovën, Pejën dhe Mitrovicën.

**PROF. DR. ERIC P. HAMP MERR FLETËDËSHMINË E
ANËTARIT TË JASHTËM TË ASHAK-ut**

Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 7 tetor 2005, në praninë e anëtarëve të Akademisë, të përfaqësuesve të Degës së Gjuhësisë të Fakultetit të Filologjisë dhe të Degës së Gjuhësisë të Institutit Albanologjik të Prishtinës, u organizua ceremonia e dorëzimit të Fletëdëshmisë për anëtarin e jashtëm të ASHAK-ut prof. dr. Eric P. Hamp. Prof. Hamp është zgjedhur anëtar i jashtëm i Akademisë sonë nga Kuvendi i Akademisë, më 3 prill 1991.

Dorëzimin e Fletëdëshmisë e bëri akademik Rexhep Ismajli, kryetar i Akademisë, i cili para të pranishmëve shpalosi një pasqyrë të pasur të punës kërkimore – shkencore të prof. Hamp-it, duke i theksuar në veçanti studimet e tij në fushë të albanistikës, të cilat të përmbledhura në një vëllim të veçantë do t'i botojë Akademia jonë.

Profesori Hamp, në fjalën e tij të rastit shpjegoi historinë e interesimit të tij për shqipen dhe popullin shqiptar, përjetimet e tij midis shqiptarëve. Ai theksoi mikpritjen dhe ngrohtësinë që ka gjetur midis shqiptarëve të cilën, siç e tha vetë, askund tjetër s'e ka hasur. U shpreh se ndihet krenar që është përsëri në mesin tonë.

Gjatë vizitës së tij në vendin tonë, prof. Hamp vizitoi Prizrenin.

SHËNOHET 30-VJETORI I ASHAK-ut

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, më 21 tetor 2005, shënoi 30-vjetorin e themelimit të saj. Në sallën solemne të Fakultetit Filologjik të Prishtinës, në praninë e anëtarëve të Akademisë, delegacionit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të kryesuar nga kryetari i saj akademik Ylli Popa, nënkrytares së Akademisë Sllovene të Shkencave dhe të Arteve, akademik Alenka Shelih, anëtarit të Kryesisë së Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe të Arteve, akademik Bojan Shaptrajanov, të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, akademik Nexhat Daci, kryeministrit të Kosovës, z. Bajram Kosumi, përfaqësuesit të Kryetarit të Kosovës, z. Sali Caci, të z. Agim Veliu, ministër i Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, kryetarit të Komunës së Prishtinës, z. Ismet Beqiri, përfaqësuesve të Universitetit të Prishtinës, përfaqësuesit të Universitetit të Evropës Juglindore të Tetovës, dekanëve të fakulteteve të UP-së, drejtorëve të instituteve dhe institucioneve shkencore e kulturore të Kosovës, përfaqësuesve të UNMIK-ut, TMK-së, KFOR-it, SHPK-së, përfaqësuesve të zyrave të huaja në Prishtinë, bashkëpunëtorëve shkencorë të Akademisë e të medieeve, u mbajt Akademia solemne kushtuar këtij përvjetori të rëndësishëm. Fjalën e rastit e mbajti akademik Rexhep Ismajli, kryetar i Akademisë.

Përsëritet me këtë rast z. Bajram Kosumi, në emër të Qeverisë së Kosovës, akademik Eduard Sulstarova, në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Alenka Shelih, në

emër të Akademisë Slovene të Shkencave dhe të Arteve, akademik Bojan Shaptrajanov, në emër të Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe të Arteve.

Për pjesëmarrësit e Akademisë solemne Filharmonia – Opera e Kosovës, e udhëhequr nga akademik Rauf Dhomi, dha një program të pasur e të nivelit të lartë artistik dhe me atë rast u ekzekutuan pjesë nga veprat e kompozitorëve P.Gaci, R.Dhomi, G.Foure, G. Verdi, L.V. Bethoveen, G. Bizet, T. Albinoni dhe A. Vivaldi.

TRYEZË SHKENCORE PËR TERMINOLOGJINË ISLAME

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Fakulteti i Studimeve Islame organizuan Tryezën shkencore me temë TERMINOLOGJIA ISLAME. Tryeza u mbajt në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 10 nëntor 2005. Fjalën e hapjes e mbajti akademik Ekrem Murtezai, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore të Akademisë, ndërsa kumtesat e tyre i lexuan njohësit e kësaj problematike nga Prishtina: akademik Jashar Rexhepagiq, anëtari korrespondent Pajazit Nushi, dr. Feti Mehdiu, mr. Qemajl Morina, dr. Abdullah Hamiti, dr. Shefkije Islamaj, mr. Isa Bajçinca, nga Tirana dr. Ramiz Zekaj, nga Shkupi dr. Ismail Bardhi dhe dr. Metin Izeti, nga Gjilani dr. Qazim Qazimi dhe nga Tetova mr. Elez Ismaili.

Në Tryezë morën pjesë anëtarë të Akademisë dhe të institucioneve shkencore e kulturore të Kosovës. Tryeza u vlerësua e suksesshme nga pjesëmarrësit.

PËRFAQËSUESIT E ASHAK-ut NË KONFERENCËN SHKENCORE PËR 450-VJETORIN E BOTIMIT TË “MESHARIT” TË GJON BUZUKUT

Në Konferencën shkencore për 450-vjetorin e botimit të “*Mesharit*” të Gjon Buzukut, që e organizoi Akademia e Shkencave e Shqipërisë në mjediset e saj më 18 nëntor 2005, morën pjesë dhe lexuan kumtesat e tyre edhe përfaqësuesit e Akademisë sonë:

- akademik Rexhep Ismajli: “Studimet buzukiane në vitet ’50 të shekullit 20”;
- akademik Besim Bokshi: “Sistemi rasor te Buzuku”;
- akademik Idriz Ajeti: “Gjuha e “*Mesharit*” të Buzukut dhe e folmja e Shestanit”.

Në Konferencë, akademikët Rexhep Ismajli dhe Besim Bokshi drejtuan nga një seancë dhe diskutuan për kumtesat e ndryshme.

PËRURohen NË TIRANË VEPRAT E I. AJETIT DHE TË W. FIEDLERIT

Pas përfundimit të punimeve të Konferencës shkencore për 450-vjetorin e botimit të “*Mesharit*” të Buzukut, po më 18 nëntor 2005, në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u organizua veprimtari përruese për dy vepra:

1. Akademik Idriz Ajeti: “Studime dialektologjike dhe etimologjike”, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë;
2. Anëtari i jashtëm i ASHAK-ut, prof.dr. Wilfried Fiedler: “Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555)”, botim i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Për veprën e Idriz Ajetit folën: akademik Shaban Demiraj, akademik Rexhep Ismajli, akademik Besim Bokshi, prof. dr. Gjovalin Shkurtaç dhe vetë autori, akademik Idriz Ajeti.

Për veprën e Wilfried Fiedlerit folën: akademik Shaban Demiraj, akademik Rexhep Ismajli, prof. dr. Emil Lafe, prof. dr. Ethem Likaj, prof. dr. Koleç Topalli dhe autori, prof. dr. Wilfried Fiedler.

MBLIDHET NË TIRANË KËSHILLI NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE

Në organizim të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, më 19 nëntor 2005, u mbajt mbledhja e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, në të cilën morën pjesë të gjithë anëtarët nga Kosova. Pala nga Kosova i paraqiti në mbledhje raportet e grupeve të punës për çështje

të drejtshkrimit, për leksik dhe terminologji, për fjalët e huaja dhe për çështje sintaksore. Pala nga Shqipëria mbajti raportin për çështje të drejtshkrimit, në të cilin ishin përfshirë edhe çështje të shkrimit të emrave të huaj.

Këshilli i mori në dijeni raportet, të cilat iu shpërndanë anëtarëve, dhe vendosi që një grup pune i Këshillit, i përbërë nga akademik Besim Bokshi dhe prof.dr. Emil Lafe, të punojë në një afat prej dy javësh një raport të përmbledhur për propozimet e grupeve përkatëse për çështjet e drejtshkrimit, në mënyrë që Këshilli të diskutojë konkretisht tërë materialin e sistemuar. Për këtë arsye akademik Bokshi duhet të punojë bashkë me prof. dr. Lafen në Tiranë, brenda pjesës së parë të dhjetorit.

SHËNOHET 600-VJETORI I LINDJES SË SKËNDERBEUT

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Instituti i Historisë-Prishtinë, me rastin e 600-vjetorit të lindjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, organizuan simpoziumin shkencor ndërkombëtar: GJERGJ KASTRIOTI - SKËNDERBEU DHE EPOKA E TIJ. Me organizimin e Simpoziumit u mor Këshilli organizues me këtë përbërje: dr. Jusuf Bajraktari, kryetar, akademik Hivzi Islami, anëtar, prof. dr. Pajazit Nushi, anëtar, prof. dr. Ymer Jaka, anëtar, prof. dr. Selim Daci, anëtar, prof. dr. Fehmi Rexhepi, anëtar, dr. Lush Camaj, anëtar, prof. dr. Ramiz Abdyli, anëtar, dhe mr. Riza Rexha, anëtar.

Simpoziumi u mbajt nën përkuqjesjen e kryetarit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, më 21 nëntor 2005, në sallën e hotelit “Grand Prishtina” të Prishtinës.

Në simpozium morën pjesë anëtarët e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, punonjës shkencorë të Institutit të Historisë të Prishtinës, të Institutit të Historisë të Tiranës, studiues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Mali i Zi, përfaqësues të institucioneve qeverisëse të Kosovës, përfaqësues të zyrave të huaja, përfaqësues të institucioneve shkencore e arsimore dhe të ftuar të tjerë. Mori pjesë dhe e përshëndeti Simpoziumin z. Agim Veliu, ministër i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë në Qeverinë e Kosovës. Telegramin e

kryetarit Rugova, me të cilin ai e përshëndet Simpoziumin, e lexoi z. Sali Cacaj, këshilltar i kryetarit Rugova. Punimet e Simpoziumit u ndoqën nga mediet e shkruara dhe elektronike.

Fjalën e hapjes e mbajti akademik Rexhep Ismajli, kryetar i ASHAK-ut. U lexuan këto kumtesa:

1. Dr. Jusuf Bajraktari, Prishtinë, Figura e Skënderbeut në historiografinë e Kosovës;
2. Prof. dr. Ferit Duka, Tiranë, Tokat e Kastriotëve;
3. Prof. dr. Oliver Schmitt, Wien, Skënderbeu - strukturat e një qeverisjeje në mesjetën e vonë;
4. Prof. dr. Kasem Biçoku, Tiranë, Kastriotët në Dardani;
5. Prof. dr. Nuray Bozborra, Stamboll, Roli i Skënderbeut në ndërtimin e identitetit nacional shqiptar (e përktheu dhe e lexoi mr. Lindita Rugova);
6. Prof. dr. Istfan Schütz, Budapest, Raportet e Skënderbeut me Huniadin (e lexoi prof. dr. Muhamet Shatri);
7. Prof. dr. Selim Daci, Prishtinë, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu kryendërtues i Besëlidhjes së Lezhës;
8. Prof. dr. Pajazit Nushi, Prishtinë, Trajtimi enciklopedik i Skënderbeut;
9. Prof. dr. Ymer Jaka, Prishtinë, Jehona e veprës së Barlecit në Francë;
10. Prof. dr. Iljaz Rexha, Prishtinë, Skënderbeu sipas kronikave osmane të shek. XV-XVI;
11. Akademik Kristo Frashri (Tiranë), Vendi i Skënderbeut në historinë shqiptare dhe evropiane (e lexoi Sokol Gjermani);
12. Chiaramonte, Palermo, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në jetën dhe kulturën e Sicilisë;
13. Piktur i merituar Kujtim Buza, Tiranë, Skënderbeu ne monu-mente;
14. Prof. Dr. Sergey Roussev, Sofje, Figura e Skënderbeut në historiografinë bullgare;
15. Mr. Mark Gjokaj, Ulqin, Skënderbeu dhe Alfonsi i Pestë;
16. Prof. dr. Enes Pelidija, Sarajevë, Skënderbeu në historiografinë boshnjake (e lexoi Teuta Shala);
17. Don Frrok Zefi, Zagreb, Skënderbeu në literaturën kroate;

18. Prof. dr. Ramiz Abdyli, Shkup, Skënderbeu sipas Gjorgje Pulevskit;
19. Prof. dr. Klara Kodra, Tiranë, Skënderbeu në veprën e De Radës, Gabriel Darës dhe Skiroit;
20. Prof. dr. Fehmi Rexhepi, Prishtinë, Skënderbeu në tekstet shkollore të historisë në Kosovë;
21. Dr. Lulzim Lajçi, Prishtinë, Skënderbeu dhe Lufta e Dytë e Kosovës;
22. Ismajl Doda, Tivar, Skënderbeu në traditën popullore shqiptare në Mal të Zi.

Fjalën e mbylljes së punimeve të Simpoziumit e mbajti dr. Jusuf Bajraktari, drejtor i Institutit të Historisë në Prishtinë.

SHËNOHET 200-VJETORI I ARDHJES SË MEHMET ALI PASHËS VALI I EGJIPTIT

Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 22 nëntor 2005, në kuadër të Programit të punës të Seksionit të Shkencave Shoqërore të Akademisë, u shënuua 200-vjetori i ardhjes së Mehmet Ali Pashës vali i Egjiptit.

Në praninë e anëtarëve të Akademisë, të dashamirëve të emrit dhe të veprës së M. Ali Pashës dhe të medieeve, shënimin e këtij përvjetori të rëndësishëm e hapi me një fjalë rasti akademik Ekrem Murtezai. U mbajtën dy ligjërata:

Dr. Shkelzen Raça: Mehmet Ali Pasha – figurë komplekse në historinë e Kohës së Re, dhe mr. Qemajl Morina: Mehmet Ali Pasha – vali i Egjiptit dhe lidhjet e tij me personalitetet shqiptare në dritën e dokumenteve arkivore nga Arkivi Kombëtar i Egjiptit në Kajro.

Akademik Jashar Rexhepagiq në diskutimin e tij theksoi kontributin e M. A. Pashës edhe në fushën e arsimit. Ligjëratat u ndoqën me interesim nga të pranishmit.

KREU I PDK-së VIZITON ASHAK-un

Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 23 nëntor 2005, e vizitoi kreu i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), në përbërjen e të cilit ishin z. Hashim Thaçi, kryetar, prof. dr. Hajredin Kuçi, nënkryetar, dhe z. Ismajl Sylja. Ata u pritën nga akademik Rexhep Ismajli, kryetar, akademik Besim Bokshi, nënkryetar, akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, dhe mr. Zija Bylykbashi, sekretar i Akademisë.

Kryetari Ismajli u uroi mirseardhjen mysafirëve dhe i informoi ata për ndërtimin e Akademisë, punën e deritashme dhe për synimet e saj.

Z. Thaçi shpjegoi se vizita e tij dhe e shoqëruesve të tij në Akademi është në funksion të përgatitjeve që po bëhen në prag të bisedimeve për statusin e Kosovës, duke e vlerësuar Akademinë si institucion të dijes. Ai tha se çmon rolin që ka luajtur dhe tani po luan Akademia dhe akademikët për të mirën e Kosovës. Ky rol institucional dhe moral i Akademisë është i pakompensueshëm për çështjen e Kosovës. Argumentimi shkencor i së drejtës sonë se Kosova duhet të bëhet shtet i pavarur dhe sovran, për institucionet tona dhe për grupin negociator është i një rëndësie të veçantë. Sugjerimet nga Akademia janë të mirëseardhura edhe për ne politikanët. Përcaktimet tona janë të qarta. Kosova duhet të bëhet shtet i pavarur dhe sovran, gjithsesi demokratik, në të cilin do të respektohen të drejtat e barabarta për të gjithë qytetarët e tij.

Prof. dr. H. Kuçi, ndër të tjera, tha se Akademia duhet të jetë aktive në procesin e bisedimeve duke argumentuar të drejtën tonë, duke ndihmuar në krijimin e opinionit publik pozitiv, brenda dhe jashtë vendit dhe përmes interpretimit të zgjidhjeve që ofrohen për Kosovën.

Kryetari Ismajli theksoi se përcaktimi i Akademisë është për Kosovën, jo për partitë e saj. Akademia dhe anëtarët e saj janë të gatshëm ta japin kontributin e tyre edhe për procesin e bisedimeve lidhur me statusin e Kosovës, për aq sa kanë fuqi. Akademia është institucion, i cili nuk bën të lihet anash.

VICTOR A. FRIEDMAN LIGJËRON NË ASHAK

Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 23 nëntor 2003, linguisti, ballkanologu, sllavisti dhe albanologu amerikan, anëtar i jashtëm i kësaj Akademie, Victor A. Friedman (1949), mbajti ligjëratën inauguruese me temë: “Gjuha shqipe, gjuhësia ballkanike dhe ballkanizimi i Ballkanit”. Ligjërata u ndoq me interesim nga anëtarët e Akademisë, arsimtarët e Degës së Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Fakultetit Filologjik, nga studiues të Institutit Albanologjik dhe nga mediet. Ligjërata u vlerësua e suksesshme.

Po në këtë ditë, në një ceremoni rasti, kryetari i Akademisë, akademik Rexhep Ismajli, ia dorëzoi profesorit Friedman Fletë-dëshminë e zgjedhjes së tij *anëtar i jashtëm i ASHAK-ut*. Profesori Friedman shprehu fjalë falënderimi për zgjedhjen e tij anëtar i kësaj Akademie.

Profesor Friedman është zgjedhur anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 21 dhjetor 2004.

KRYETARI I ASHAK-ut VIZITON AKADEMINË SLLOVENE TË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE

Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Rexhep Ismajli, më 25 nëntor 2005, vizitoi Akademinë Sllovene të Shkencave dhe të Arteve. Ai u prit nga kryetari i saj akademik Boshtjan Žekš dhe nga akademikët Janez Orešnik e Alenka Šelih.

Gjatë kësaj vizite janë arritur këto përfundime:

1. Veprat e fushës së albanologjisë të Fran Miklošič-it dhe të Rajko Nahtigal-it do të nxirren si botim i përbashkët i të dy akademive. Në Redaksinë e përbashkët, njëri nga anëtarët nga ana sllovene do të ishte prof. Janez Orešnik dhe se pjesëmarrja e albanologut slloven prof. Marko Snoj në këtë ndërmarrje është esenciale. Akademia e Kosovës merr përsipër përkthimin e veprave në gjuhën shqipe, ndërsa ajo sllovene merr përsipër përkujdesjen për transkriptimin e

- tekstit në formë kompjuterike. Vepra do të mund të botohej në dy ose tri vëllime;
2. Të bëhen përpjekje për hapjen e lektoratit të gjuhës shqipe në Lubjanë, gjegjësisht të gjuhës sllovene në Prishtinë, mbi bazën e reciprocitetit.
 3. Bashkëpunimi midis dy akademive do të mund të vendosej edhe në fushën e bujqësisë, sidomos në lëmin e sëmundjeve virusale të hardhive të rrushit (prof. Jože Maček dhe prof. Latif Susuri do të mund të gjenin interes të përbashkët hulumtues);
 4. Shkëmbimi i botimeve i të dy akademive do të duhej të përmirësohej me synim të sigurimit të një shkëmbimi të rregullt nga të dy anët.
 5. Nga kryetari Ismajli u ngrit edhe çështja e bashkëpunimit edhe për fusha të tjera, siç janë: arkeologjia dhe aktivitetet muzeore.

Njëherësh, kryetari i ASHAK-ut propozoi shkëmbimin e mundshëm të ekspozitave dhe konkretisht ai theksoi se ekspozita sllovene, që po përgatitet në Shkup, do të mund të transferohej në Prishtinë. Iniciativa do t'i përcillet sekretarit të seksionit përkatës, akademikut Andrej Jemec.

Në fund të takimit, akademik Ismajli e ftoi zyrtarisht kryetarin Žekš për një vizitë në Prishtinë, të cilën ai e pranoi, por nuk u vendos për detajet e kësaj vizite.

NË TIRANË DHE PRISHTINË SHËNOHET 60-VJETORI I LINDJES SË AKADEMIK RAUF DHOMIT

Ministria e Kulturës dhe e Sporteve e Shqipërisë dhe Teatri Kombëtar i Operës dhe i Baletit shënuan në Tiranë, më 4 dhjetor 2005, 60 – vjetorin e lindjes së akademik Rauf Dhomit. Me këtë rast TKOB dhe RTSH shfaqen një program të pasur, i cili në vete ngërthente takime, vlerësime për artistin dhe përshëndetje nga artistët. Manifestimi u mbajt në mjediset e TKOB-së. Programi nisi me përshëndetjen e drejtorit Zhani Ciko, për të vazhduar me ekzekutimin e pjesëve të zgjedhura nga opusi i pasur i akademikut Dhomi.

Edhe në Prishtinë, më 5 dhjetor 2005, në sallën e kuqe të Pallatit të Rinisë dhe të Sporteve u shënua 60-vjetori i lindjes së kompozitorit të shquar akademik Rauf Dhomi. Merrnin pjesë Kryetari dhe anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, kryeministri i Kosovës, z. Bajram Kosumi, i cili i uroi ditëlindjen akademikut Dhomi dhe e përgëzoi për kontributin që ka dhënë dhe që pritet ta japë në fushën e muzikës, dhe ministra të kabinetit të tij, përfaqësues të zyrave të huaja dhe shumë dashamirës të veprës artistike të akademikut Dhomi.

KONFERENCË SHKENCORE PËR FAIK KONICËN

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë organizuan KONFERENCËN SHKENCORE PËR FAIK KONICËN në mjediset e ASHAK-ut, më 8 dhjetor 2005. Fjalën e hapjes e mbajti akademik Ali Aliu, kryetar i Këshillit organizues të Konferencës. Me kumtesat e tyre u paraqitën:

1. Sabri Hamiti: KONICA BASHKËKOHËS YNI
2. Jorgo Bulo: FAIK KONICA DHE ÇAJUPI
3. Luan Starova: FAIK KONICA DHE REMY DE GOURMONT
4. Alfred Uçi: SHKRIMI DHE KARAKTERI EKSENTRIK
5. Kujtim Shala: LETRAT E KONICËS
6. Floresha Dado: VËSHTRIM INTERTEKSTUAL I VEPRËS SË FAIK KONICËS
7. Remzi Përnaska: PËR MENDIMIN TEORIK GJUHËSOR TË FAIK KONICËS (Gjuhët e sendërgjuara dhe gjuhët natyrore)
8. Fatmir Sulejmani: GABIMET E KONICËS NË DIOPTRINË E STUDIUESVE SHQIPTARË
9. Basri Çapriqi: FAIK KONICA - DISIDENCA E PËRJETSHME
10. Ali Aliu: FAIK KONICA SOT
11. Kristaq Jorgo: NË KËRKIM TË RRËNJËVE TË LLOJIT
12. Mehmet Kraja: KATËR DILEMA PËR FAIK KONICËN
13. Hamit Xhaferi: PROZAT POETIKE TË KONICËS
14. Agron Tufa: FAIK KONICA DHE IRONIA E PAFUQISË

15. Sali Bashota: IDETË DHE KONCEPTET LETRARE TË FAIK KONICËS

Fjalën përmbyllëse e mbajti Sabri Hamiti.

STUDIUES EDHE NGA ASHAK-u DHE KOSOVA MARRIN PJESË NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE “GJERGJ KASTRIOTI-SKËNDERBEU DHE EVROPA”

Në Konferencën ndërkombëtare “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe Evropa”, që e organizuan Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Instituti i Historisë në Tiranë, më 9 e 10 dhjetor 2005, përveç studiuesve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Mali i Zi, morën pjesë edhe studiues nga Bullgaria, Greqia, Gjermania, Austria, Italia dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Anëtari korrespondent i Akademisë sonë, Pajazit Nushi, e përshëndeti Konferencën në emër të ASHSAK-ut dhe të kryetarit të saj akademik Rexhep Ismajli. Në Konferencë u mbajtën gjithsej 47 kumtesa (nga Kosova 15), ndër to edhe kumtesa e prof. Nushit me titull: “Trajtimi enciklopedik i Skënderbeut”.

Për pjesëmarrësit e Konferencës u organizuan vizita në Lezhë, në Kështjellën e Krujës dhe në Muzeun e Skënderbeut në Krujë.

KRYEADMINISTRATORI I KOSOVËS VIZITON ASHAK-un

Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, z. Soren-Jessen

Petersen, më 15 dhjetor 2005, vizitoi Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Z. Petersen u prit nga anëtarët e Akademisë. Kryetari i Akademisë akademik Rexhep Ismajli i uroi mirëseardhjen dhe me këtë rast i foli për arritjet kryesore të Akademisë në 30 vjetët e shkuar, duke veçuar:

- është mbajtur veprimtaria themelore në fushat e shkencës, të dijeve dhe të arteve;

- është zhvilluar më tej veprimtaria botuese, me vepra të veçanta dhe me revistat shqip dhe në gjuhët me qarkullim ndërkombëtar;
- është ndërtuar dhe zhvilluar veprimtaria e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke integruar ASHAK-un në mekanizmat evropianë dhe të Evropës Juglindore dhe duke zhvilluar bashkëpunimin me akademitë përreth (Shqipërinë, Kroacinë, Slloveninë, Maqedoninë, Malin e Zi, tani me Turqinë), si dhe me Britaninë e Madhe, Belgjikën, Gjermaninë, Italinë, etj.

Akademia jonë, edhe pse ka punuar në rrethana të jashtëzakonshme si asnjë tjetër në Evropë, ka arritur:

- ta ruajë dhe ta ushqejë më tej identifikimin me aspiratat e popullit të Kosovës;
- ta ruajë dhe ta ushqejë drejtpeshimin e nevojshëm për të ushqyer më tej miqësitë me popujt e tjerë dhe sidomos me fqinjët;
- të nxjerrë mendimtarë dhe veprimtarë të shquar të këtij populli në luftën për emancipim, për zhvillim paqësor dhe miqësi me të tjerët;
- të përballojë me krenarinë e ligjshme humbjet që i ka shkaktuar pushteti, për ne okupues, i Serbisë, në fillim, dhe me mbylljen dhe dëbimin e saj nga kjo godinë dhe deri në vrasjen më në fund të anëtarit tonë, kampionit të lëvizjes paqësore dhe të miqësisë më 1999 – akademikut Fehmi Agani, dhe
- me këto vlera, në raport me disa akademi përreth, ne mburremi.
- Kryetari Ismajli, në vazhdim të fjalës së tij tha: “Në këta 6 vjetët e pasluftës janë shënuar shumë rezultate në zhvillimin e Kosovës. Njëherësh, me keqardhje konstatojmë tri pika themelore të ngecjeve, që, për mendimin tonë, janë burim i shumë mosfunksionimeve të tjera:
- persistimi i ndarjes së Mitrovicës dhe mungesa e vullnetit për ta zgjidhur këtë problem;
- eliminimi i strukturave paralele serbe në vise të ndryshme të Kosovës;
- mungesa e një procesi të shënueshëm të zhvillimit ekonomik.

Të gjitha këto për ne lidhen drejtpërsëdrejti me mungesën e statusit të Kosovës, me mungesën e identitetit të saj ndërkombëtar.

Synimet tona të përgjithshme drejt integriteteve rajonale, evropiane dhe më të gjera, ashtu si dhe nxitjet ndërkombëtare në këtë drejtim, vihen në rrezik pikërisht nga izolimi që na imponohet për këto arsye.

Zotit Petersen ia paraqiti edhe shqetësimet e mëdha për ne:

- pas gjithë historisë së dy dekadave të fundit,
- pas përvojës së gjatë të rezistencës më të madhe paqësore që ka njohur Evropa,
- pas detyrimit për të hyrë në rezistencë të armatosur dhe ndihmës ndërkombëtare përmes ndërhyrjes më të madhe ushtarake që ka ndërmarrë ndonjëherë Perëndimi (NATO), ne e dimë, besojmë, dhe fuqimisht qëndrojmë në bindjen se popullit të Kosovës dhe Kosovës nuk mund t'i mohohet e drejta e vetëvendosjes,
- e dimë po ashtu se gjendja në të cilën jemi kërkon që kjo e drejtë të realizohet përmes një procesi delikat dhe kompleks në kuadër të Kombeve të Bashkuara dhe të mekanizmave ndërkombëtarë,
- e dimë se në këtë proces duhet të adresohen çështjet themelore për të ardhmen e Kosovës, çështja e minoriteteve dhe e vlerave të tyre kulturore e të tjera, çështja e funksionimit të shtetit dhe të shoqërisë që po projektojmë.

Në ASHAK dhe në shoqëri mbisundon mendimi se sa u përket minoriteteve është detyrë jona që të sigurojmë kuantumin e plotë të të drejtave në të gjitha aspektet;

Këto të drejta të minoriteteve duan parë universalisht, në kuadër të rajonit dhe të Evropës; rregullimi i të drejtave legjitime të minoriteteve, që të jetë i qëndrueshëm, duhet të kalojë nëpër procesin e respektimit të të drejtave të popullatës shumicë gjithashtu.

Na shqetësojnë disa propozime për eksperimentime në këtë drejtim, ashtu si dhe kërkesat e disa instancave ndërkombëtare për të qenë gati të pranojmë “kompromise të dhimbshme”.

Të drejtat e minoriteteve, sipas mendimit tonë, janë legjitime dhe kjo nuk mund të jetë e dhimbshme, përkundrazi.

Nëse saktësimi “e dhimbshme” ka të bëjë me të drejtat e popullit shumicë, ne nuk mund ta kuptojmë logjikën e këtij qëndrimi.

E kuptojmë që për Serbinë dhe për Shqipërinë a Maqedoninë çështja e Kosovës është e rëndësishme, por duhet të mos harrojmë se për ne kjo është çështje ekzistenciale.

Duam të themi me këtë rast se mbrojtja e minoriteteve dhe e të drejtave e të trashëgimisë kulturore të tyre duhet parë si çështje të Kosovës: mbrojtja e tyre e vetme e qëndrueshme është mbrojtja nga rrethi miqësor, që është shumica.

Nëse nuk ka zgjidhje miqësore për shumicën, të gjitha ato propozime shndërrohen në investim për armiqësi të mëtejme dhe këtu kemi përgjegjësi të përbashkët – vendorët ashtu si ndërkombëtarët, por edhe shtetet përreth, që kanë hyrë në një garë licencimesh për zgjidhje të ndryshme.

Thellësisht i bindur se Kosova dhe populli i saj do të vazhdojnë ta gëzojnë mbështetjen dhe angazhimin Tuaj kështu dinamik dhe të sinqertë për zgjidhjen e problemeve kaq të mëdha, edhe një herë Ju uroj mirëseardhjen në ASHAK.

Zoti Petersen, në fjalën e tij, ndër të tjera, tha se e çmon Akademinë dhe rezultatet e saj. Kosova ka hyrë në një proces të pakthyeshem të përcaktimit të statusit të saj. Ky është një moment i rëndësishëm për Kosovën. Ka filluar procesi i negociatave. Ka njerëz që mendojnë se nuk duhet të negociohet. Mendoj se duhet të negociohet. Kështu mendojnë edhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Procesi i përcaktimit të statusit nuk është aspak i lehtë. Zbatimi i standardeve të përcaktuara duhet të vazhdojë. Pres nga populli i Kosovës një zë të fuqishëm, se atë që dëshiron për vete (shumicën) e dëshiron edhe për minoritetet; e vlerëson ngritjen e Këshillit për minoritetet. Serbët, deri tash kanë qenë ambivalentë, por është shumë me rëndësi të dëgjohet edhe zëri i tyre. Shumica duhet t’i marrë me vete edhe pakicat, duke i marrë parasysh edhe kërkesat e tyre, por njëkohësisht edhe pakicat duhet ta marrin parasysh vullnetin e shumicës.

Decentralizimi është me rëndësi të veçantë për Kosovën. I rëndësishëm edhe për pakicat, sepse ai u mundëson atyre ushtrimin e përgjegjësive aty ku jetojnë. Duke i marrë parasysh të gjitha këto që u thanë, mund ta parafytyrojmë një kornizë të re të Kosovës. Kosova do

të jetë një dhe e pandarë, jo e bashkuar me asnjë shtet fqinj, nuk do të kthehet ku ka qenë, do t'i ketë këto institucione që i ka sot, me mekanizma mbrojtës për minoritetet. Kosova do të jetë me një qeverisje të decentralizuar në favor të të gjithëve, ku do të mbrohet e gjithë trashëgimia kulturore dhe aktiviteti i saj do të fokusohet në kthimin e të zhvendosurve. Vendosija e statusit për Kosovën do të ndikojë në zhvillimin ekonomik, pasi që ajo do të jetë anëtare e institucioneve ndërkombëtare financiare prej nga do të tërheqë fonde.

Institucionet paralele dhe Mitrovica e ndarë janë dështimet tona. Me zgjidhjen e statusit të Kosovës, do të zgjidhen edhe këto dy çështje. Për Kosovën do të ketë rezolutë të re të Kombeve të Bashkuara dhe kjo rezolutë e re do t'i japë fund misionit të UNMIK-ut. Në fazën kalimtare bashkësia ndërkombëtare do të jetë e pranishme (OSBE-ja, NATO-ja etj.). Rezoluta e re do ta rregullojë jetën e re në Kosovë. Ju si Akademi do të keni rol të rëndësishëm edhe në të ardhmen. Jam i inkurajuar me komentet Tuaja (të kryetarit Ismajli) mjaft tolerante e gjithëpërfshirëse. Në shtetet fqinje akademitë e tyre nuk mund të krenohen me një frymë të këtillë dhe kjo frymë do të ishte mirë të bartet edhe në to. Në Kosovë do të ndërtohet një shoqëri moderne evropiane. Besoj në të ardhmen.

Kryetari Ismajli e falënderoi z.Petersen për fjalën e tij.

Në vazhdim, akademik Esat Stavileci dhe anëtari korrespondent Mehmet Kraja i shtruan pyetje z. Petersen. Akademik Stavileci i kërkoi Kryeadministratorit mendimin e tij për të drejtën për vetëvendosje të popullit të Kosovës, për të drejtat ligjore të Kosovës si subjekt konstituiv i ish- Federatës jugosllave dhe për Kosovën si subjekt ndërkombëtar me mundësi të përfitimit ekonomik dhe lidhje traktatesh. Kraja konstatoi se procesi i statusit ka mënjeluar vëmendjen nga monitorimi i kualitetit të qeverisjes nga UNMIK-u dhe Qeveria e Kosovës dhe lidhur me këtë konstatim kërkoi mendimin e z. Petersen.

Z. Petersen u dakordua se procesi i statusit i ka lënë paksa anash disa segmente të qeverisjes së vendit, duke shtuar se në këtë drejtim kanë ndikuar edhe çështje të tjera, si destabilizimi, strukturat paralele, Mitrovica e ndarë etj. Ka rritje të politizimit në shoqërinë civile (fusha e drejtësisë), korrupsioni dhe krimi i organizuar janë brengë e madhe. Cilësia e qeverisjes të trajtohet njësoj si në partitë politike. Grupi

politik për statusin e Kosovës duhet të kontaktojë me popullin, kjo nuk po ndodh sa duhet. Të gjithë e dinë se çka kërkon shumica. Vullneti i shumicës nuk mund të injorohet. Të punohet sa më shumë në mënyrë që të shihet se Qeveria dhe populli po e fitojnë statusin për Kosovën. Kosova do të jetë shtet me të drejtën për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare.

Për mungesë të kohës së lirë të Kryeadministratorit, disa anëtarëve të tjerë të Akademisë nuk iu dha mundësia për diskutim apo për shtruarjen e pyetjeve.

Mr. Zija Bylykbashi